



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2014 – Numri: 178

Tiranë – E Hënë, 24 Nëntor 2014

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 146/2014 datë 30.10.2014	Për njoftimin dhe konsultimin publik 9189
Ligj nr. 147/2014 datë 30.10.2014	Për shërbimin e urgjencës mjekësore 9194
Ligj nr. 148/2014 datë 30.10.2014	Për ratifikimin e marrëveshjes së kredisë për eksport ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, që vepron në emër të Republikës së Shqipërisë dhe i përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe UniCredit Bank Austria AG për financimin e projektit të sistemit të ujërave të zeza të Bilishtit, “Kontratë me çelësa në dorë – loti 1” 9201
Ligj nr. 149/2014 datë 30.10.2014	Për ratifikimin e ndryshimit nr. 2 të marrëveshjes së ndihmës për objektiva zhvillimi ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës “Për forcimin e shtetit të së drejtës dhe qeverisjen e mirë dhe krijimin e kushteve për një rritje ekonomike me bazë të gjerë dhe të qëndrueshme” 9215
Ligj nr. 153/2014 datë 18.11.2014	Për faljen e kamatëvonesave dhe gjobave për kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore të papaguara nga personat e vetëpunësuar në bujqësi 9216
Dekret nr. 8797 datë 20.11.2014	Për shpallje ligji dhe dhënien e pëlqimit për hyrjen në fuqi menjëherë të ligjit 9217



LIGJ
Nr. 146/2014

PËR NJOFTIMIN DHE KONSULTIMIN
PUBLIK

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

1. Ky ligj rregullon procesin e njoftimit dhe të konsultimit publik të projektligjeve, projekt-dokumenteve strategjike kombëtare dhe vendore, si dhe politikave me interes të lartë publik.

2. Ky ligj përcakton rregullat procedurale që duhen zbatuar për të garantuar transparencën dhe pjesëmarrjen e publikut në proceset politikëbërëse dhe vendimmarrëse nga organet publike.

3. Ky ligj synon nxitjen e transparencës, të përgjegjshmërisë dhe integritetit të autoriteteve publike.

Neni 2
Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Akt administrativ individual” është çdo vullnet i shprehur nga organi publik, në ushtrim të funksionit të tij publik, ndaj një ose disa subjekteve individualisht të përcaktuara të së drejtës, që krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie juridike konkrete.

2. “Akt nënligjor normativ” është çdo vullnet i shprehur nga organi publik, në ushtrim të funksionit të tij publik, që rregullon marrëdhënie të përcaktuara me ligj, duke vendosur rregulla të përgjithshme sjelljeje dhe që nuk shteron me zbatimin e tij.

3. “Emergjencë civile” është një situatë e shkaktuar nga faktorë natyrorë, ekologjikë, industrialë, socialë, veprime terroriste, veprime

ushtarake (në gjendje lufte), të cilat sjellin dëme të menjëhershme e të rënda për jetën, për shëndetin e popullatës dhe të gjësë së gjallë, për pasurinë, për trashëgiminë kulturore dhe për mjedisin.

4. “Grup interesi” është çdo organizatë jofitimprurëse që përfaqëson interesat e një grupi personash fizikë ose juridikë, si dhe subjekte të tjera të prekura apo të interesuara për projektaktet që i nënshtrohen procesit të konsultimit publik.

5. “Konsultim publik” është tërheqja e mendimeve dhe sugjerimeve të palëve të interesuara për përmbajtjen dhe përmirësimin e projektaktit, nga momenti i publikimit të projektaktit deri në miratimin përfundimtar të tij.

6. “Ministër përgjegjës” është ministri që mbulon fushën e teknologjisë së informacionit.

7. “Njoftim paraprak” është ftesa zyrtare për të marrë pjesë në procesin e dhënies së informacioneve ose opinioneve paraprake, përpara fillimit të hartimit të projektaktit.

8. “Njoftim publik” është ftesa zyrtare për të marrë pjesë në procesin e konsultimit të projektaktit të propozuar dhe nisja e procedurave të konsultimit publik.

9. “Organ publik” është çdo organ i pushtetit qendror, i cili kryen funksione administrative, çdo organ i enteve publike, në masën që ato kryejnë funksione administrative, çdo organ i pushtetit vendor, që kryen funksione administrative, çdo organ i Forcave të Armatosura e çdo strukturë tjetër, për aq kohë sa këto kryejnë funksione administrative, si dhe çdo person fizik ose juridik, të cilit i është dhënë me ligj, akt nënligjor ose çdo lloj forme tjetër, të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, e drejta e ushtrimit të funksioneve publike.

10. “Proces i vendimmarrjes” është proces që përfshin proceset e hartimit e të miratimit nga organet publike të projektakteve.

11. “Projektakt” është projekti i një ligji, projekte të dokumenteve strategjike, kombëtare dhe vendore, të politikave me interes të lartë publik, të hartuara nga organet publike.

12. “Regjistri elektronik” është faja zyrtare e internetit ku do të publikohen projektaktet, sipas përcaktimeve të nenit 7 të këtij ligji.

13. “Rekomandim” është çdo sugjerim, propozim apo mendim me karakter konsultativ për projektaktet e hartuara, i shprehur verbalisht dhe/ose me shkrim nga palët e interesuara.



14. “Takim publik” është çdo takim i hapur me palët e interesuara për diskutimin e projektakteve që i nënshtrohen procesit të njoftimit dhe konsultimit publik, me qëllim sqarimin dhe informimin e opinionit publik në lidhje me këto projektakte, si dhe marrjen e komenteve e të rekomandimeve përkatëse për përmirësimin e tyre.

15. “Transparencë” është veprimtaria e hapur e një organi publik për të informuar në lidhje me aktet me interes të lartë publik, me proceset politikëbërëse dhe vendimmarrëse, që u siguron palëve të interesuara mundësinë për të marrë pjesë në këto procese.

Neni 3

Fusha e zbatimit

Ky ligj zbatohet për rregullat dhe procedurat e njoftimit e të konsultimit publik që zhvillohen nga organet publike në proceset politikëbërëse dhe vendimmarrëse.

Neni 4

Kufizime

Dispozitat e këtij ligji nuk zbatohen gjatë procesit të vendimmarrjes që lidhet me:

- a) çështjet e sigurisë kombëtare, për aq sa ato përbëjnë sekret shtetëror, sipas ligjit për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror”;
- b) marrëdhëniet ndërkombëtare dhe marrëveshjet dypalëshe dhe shumëpalëshe;
- c) aktet administrative individuale dhe aktet administrative me karakter normativ, përveçse kur me ligj të veçantë parashikohet ndryshe;
- ç) aktet normative, me fuqinë e ligjit, të miratuara në Këshillin e Ministrave;
- d) emergjencën civile;
- dh) çështjet e tjera përjashtimore të parashikuara me ligj.

Neni 5

Parimet në procesin e njoftimit e të konsultimit publik

Procesi i njoftimit dhe i konsultimit publik kryhet në bazë të parimeve të mëposhtme:

- a) transparenca gjatë procesit të njoftimit e të konsultimit publik me pjesëmarrje gjithëpërfshirëse dhe jodiskriminuese;

- b) efektshmëria e procesit të vendimmarrjes në organet publike;

- c) përgjegjësia e organeve publike ndaj palëve të interesuara.

KREU II

DETYRIMI PËR NJOFTIM DHE KONSULTIM PUBLIK

Neni 6

Detyrimi për njoftimin dhe konsultimin publik

1. Organet publike janë të detyruara të marrin të gjitha masat e nevojshme, në mënyrë që të krijojnë mundësi për pjesëmarrjen e publikut dhe të të gjitha palëve të interesuara në procesin e njoftimit e të konsultimit publik, përfshirë:

- a) publikimin në regjistrin elektronik të projektaktit, të njoftimit për konsultim dhe të dhënave të lidhura me konsultimin e projektakteve;

- b) publikimin në programin e transparencës, sipas ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, të planeve vjetore të organeve publike që lidhen me procesin e vendimmarrjes, në kuptim të këtij ligji;

- c) dhënien e informacionit në lidhje me procesin e njoftimit dhe të konsultimit publik në të gjitha fazat, duke filluar nga publikimi i projektaktit, marrja e komenteve dhe rekomandimeve për përmirësimin e tij, organizimi i debateve publike e deri te miratimi i aktit përfundimtar.

2. Organi publik, pas publikimit të njoftimit në regjistrin elektronik, mund të organizojë konsultime të drejtpërdrejta dhe takime publike me palët e interesuara. Konsultimet e drejtpërdrejta dhe takimet publike me palët e interesuara dokumentohen me procesverbal. Procesverbali i takimeve publike, të organizuara sipas këtij ligji, është dokument zyrtar. Për konsultime veçanërisht të rëndësishme, si dhe kurdo që është e mundur, me vendim të organit publik, takimet publike transmetohen në median audiovizive publike për të mundësuar ndjekjen e tyre nga publiku i gjerë.

3. Pavarësisht nga përcaktimet e pikave 1 dhe 2, të këtij neni, organet publike nuk përjashtohen nga detyrimi për publikimin dhe konsultimin e projektakteve, sipas ligjeve të veçanta për funksionimin e tyre.

Neni 7

Regjistri elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike

1. Çdo projektakt publikohet në regjistrin elektronik për njoftimin dhe konsultimin publik. Ky regjister është një faqe zyrtare interneti, e cila shërben si një pikë qendrore konsultimi, dhe nëpërmjet këtij regjistri sigurohet akses dhe ofrohet mundësia e komunikimit të gjitha palëve të interesuara me organin publik. Kjo formë siguron dhe forcon barazinë për sa i përket aksesit në informacion dhe shërbim, duke pasur në vëmendje dhe nevoja specifike për persona apo grupime të caktuara.

2. Krijimi dhe rregullat e administrimit të regjistrin elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike përcaktohen nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës.

KREU III

PALËT E PËRFSHIRA NË KONSULTIMIN PUBLIK

Neni 8

Palët e interesuara

1. Palët e interesuara në procesin e njoftimit e të konsultimit publik janë:

- a) organet publike;
- b) shtetasit e Republikës së Shqipërisë dhe grupet e interesit;
- c) personat fizikë të huaj me vendqëndrim të përhershëm në Republikën e Shqipërisë, si dhe personat juridikë të huaj, të regjistruar në Republikën e Shqipërisë.

2. Personat e tjerë të huaj mund të marrin pjesë në procesin e konsultimit, në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare ose me kërkesë të drejtpërdrejtë të organeve publike, kur e çmojnë të nevojshme.

Neni 9

Të drejtat e palëve të interesuara

Palët e interesuara në procesin e njoftimit dhe konsultimit publik kanë të drejtë:

- a) të kërkojnë informacion për procesin e njoftimit e të konsultimit publik, përfshirë aksesin në projektakt, sipas përcaktimit të shkronjës “a”, të pikës 1, të nenit 6, të këtij ligji, me përjashtim të rasteve të parashikuara në nenin 4 të këtij ligji;

b) t’u propozojnë organeve publike fillimin e procedurës për hartimin dhe miratimin e projektakteve, sipas planit vjetor të procesit të vendimmarrjes, publikuar nga organi publik, në përputhje me parashikimet e shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 6, të këtij ligji;

c) t’u dorëzojnë organeve publike komente dhe rekomandime për projektaktet që janë në proces të njoftimit e të konsultimit publik.

Neni 10

Koordinatori i njoftimit dhe konsultimit publik

Çdo organ publik cakton një person si koordinator të njoftimit dhe konsultimit publik, i cili është përgjegjës për bashkërendimin dhe administrimin e përgjithshëm të punës për garantimin e së drejtës së njoftimit e të konsultimit publik, të parashikuara nga ky ligj.

KREU IV

RREGULLAT E PROCESIT TË NJOFTIMIT DHE KONSULTIMIT PUBLIK

Neni 11

Mënyrat e njoftimit dhe marrja e komenteve dhe rekomandimeve

1. Njoftimi për projektaktet që do t’i nënshtrohen procedurës së konsultimit publik bëhet nëpërmjet regjistrin elektronik. Në rastet kur organi publik e konsideron të nevojshme, njoftimi mund të kryhet edhe në një apo disa nga format e mëposhtme:

- a) me postë elektronike;
- b) me lajmërim publik, i cili afishohet në ambientet e organit publik inicues;
- c) me një lajmërim në mediat audiovizive kombëtare, rajonale ose lokale;
- ç) me botimin në gazeta lokale ose në dy gazetat më të lexuara në nivel kombëtar.

2. Marrja e komenteve dhe rekomandimeve në procesin e konsultimit publik kryhet në një nga format e përmendura më sipër, si dhe në raste të caktuara në formë verbale dhe/ose me shkrim e të regjistruara në procesverbalin e takimeve publike.

Neni 12

Njoftimet paraprake

1. Organi publik, në raste të veçanta, mund të mbledhë informacione dhe/ose opinione



paraprake nga grupet e interesit përpara se të nisë procesin e hartimit të aktit përkatës.

2. Në fazat fillestare, organi publik, kur e gjykon të nevojshme, publikon në një nga format e parashikuara në nenin 11 një njoftim paraprak për aktin që do të hartojë për të siguruar informacione nga palët e interesuara.

3. Çdo palë e interesuar mund t'i përgjigjet njoftimit paraprak brenda afateve të parashikuara në këtë ligj, duke dorëzuar komente dhe rekomandime.

Neni 13

Përmbajtja e njoftimit në lidhje me nismën vendimmarrëse

1. Në njoftimin për fillimin e procesit të konsultimit publik duhet të përcaktohen të paktën:

a) arsyet e nevojshme për nxjerrjen e projektaktit, si dhe ndikimi që ai do të ketë;

b) afati, vendi dhe mënyra me të cilën palët e interesuara paraqesin ose dërgojnë rekomandimet e tyre;

c) adresa e kontaktit të koordinatorit për njoftimin dhe konsultimin publik të organit publik për mbledhjen e rekomandimeve e të komenteve për projektaktin;

ç) vendi dhe data e organizimit të takimit publik në rastet kur organi publik vendos për organizimin e tij.

2. Aksesi në dokumentacionin e nevojshëm që lidhet me projektaktin sigurohet edhe sipas mënyrës së përcaktuar në legjislacionin në fuqi për të drejtën e informimit.

Neni 14

Informacioni që nevojitet të sigurohet

1. Palët e interesuara që do të konsultohen, pajisen me informacionin e nevojshëm për t'u krijuar atyre mundësinë të kontribuojnë në mënyrën më efektive të mundshme në procesin e përgatitjes së projektaktit në rrugë elektronike dhe/ose postare.

2. Krahas dokumenteve përkatëse, në varësi të kompleksitetit, volumit dhe karakteristikave të tjera të projektaktit, sigurohen shpjegime për qëllimin, problemet që do të trajtohen, idetë e përgjithshme, ndryshimet kryesore dhe/ose alternativat e mundshme dhe, për aq sa është e mundur, studime apo analiza që janë kryer për hartimin e projektaktit.

Faqe | 9192

Neni 15

Afati për dorëzimin e komenteve dhe rekomandimeve

1. Palëve të interesuara u jepet koha e arsyeshme për të dërguar pranë organit publik vendimmarrës komentet dhe rekomandimet e tyre:

a) brenda 20 ditëve pune nga data e njoftimit për procesin e njoftimit paraprak;

b) brenda 20 ditëve pune nga data e njoftimit për procesin e njoftimit e të konsultimit publik.

2. Për akte veçanërisht komplekse ose të rëndësishme, sipas vendimit të organit publik, afati për dërgimin e komenteve mund të zgjatet deri në 40 ditë pune nga data e njoftimit.

3. Përcaktimet e sipërpërmendura nuk anashkalojnë afatet kohore të përcaktuara në ligje të veçanta për procedurat e konsultimit dhe informimit publik.

Neni 16

Zgjatja dhe përsëritja e fazës së konsultimit

Organi publik mund të zgjasë afatin për dërgimin e komenteve ose mund të ripërsëritë fazën e marrjes së komenteve e të rekomandimeve në rastet kur:

a) organi publik nuk është i kënaqur me cilësinë e komenteve të përfuara;

b) në komentet dhe rekomandimet e dhëna janë ngritur çështje të reja të rëndësishme që nuk kanë qenë pjesë e konsultimit fillestar.

Neni 17

Njoftimi për takime publike

1. Gjatë periudhës së konsultimit, nisur nga rëndësia e projektaktit dhe interesi i lartë publik, organi publik mund të organizojë takime publike, ku palët e interesuara paraqesin opinionin e tyre dhe të dhëna për projektaktin që do të hartohet.

2. Palëve të interesuara, të ftuara për të marrë pjesë në takimet publike, u jepet koha e nevojshme për përgatitje. Në çdo rast, ato informohen jo më pak se 20 ditë pune përpara takimit publik, duke u vënë në dispozicion kopje të projektaktit që do të diskutohet.

Neni 18

Pjesëmarrja në takimet publike

1. Konsultimi në takime publike është i hapur.



2. Njoftimi për organizimin e takimeve publike bëhet sipas mënyrave të njoftimit, të parashikuara në nenin 11 të këtij ligji.

3. Përfaqësuesi i organit publik, që drejton takimin, në përputhje me rregullat e organit publik, u ofron pjesëmarrësve mundësinë për të shprehur mendimin e tyre për çështjet që diskutohen.

4. Në çdo takim publik mbahet procesverbal, i cili arkivohet pranë organit publik.

5. Nëse konsiderohet e nevojshme, takimi publik mund të regjistrohet.

6. Procesverbalet dhe regjistrimet e takimeve publike mund të bëhen publike sipas kërkesës së paraqitur, në përputhje me legjislacionin në fuqi për të drejtën e informimit mbi dokumentet zyrtare.

Neni 19

Shqyrtimi i komenteve dhe rekomandimeve

1. Komentet dhe rekomandimet e marra gjatë procesit të konsultimit publik grumbullohen nga koordinatori i njoftimit dhe konsultimit publik të organit publik përkatës në një mënyrë të strukturuar dhe transparente.

2. Shqyrtimi i komenteve dhe rekomandimeve kryhet nga organi publik përgjegjës për hartimin e projektaktit, i cili vendos për pranimin ose refuzimin e rekomandimeve të marra nga palët e interesuara të konsultuara.

3. Projektaktet shoqërohen me një përmbledhje të rekomandimeve të pranuar, sipas dispozitave të këtij ligji. Nëse rekomandimet e palëve të interesuara nuk janë pranuar, atëherë organi publik paraqet një përmbledhje të arsyeve për mospranimin e tyre në një nga format e njoftimit, të parashikuara në nenin 11 të këtij ligji.

Neni 20

Raportet për transparencën në procesin e vendimmarrjes

1. Organet publike janë të detyruara të hartojnë dhe të publikojnë raporte vjetore për transparencën në procesin e vendimmarrjes, ku përfshihet informacion për:

a) numrin e akteve të miratuara nga organi publik përkatës gjatë vitit referues;

b) numrin e përgjithshëm të rekomandimeve të marra nga palët e interesuara;

c) numrin e rekomandimeve e të komenteve të pranuar dhe të refuzuara gjatë procesit të vendimmarrjes;

ç) numrin e takimeve publike të organizuara.

2. Raporti vjetor për transparencën në procesin e vendimmarrjes publikohet sipas parashikimeve të nenit 11 të këtij ligji.

KREU V

KOMPETENCAT DHE PROCEDURAT PËR SHQYRTIMIN E ANKESAVE

Neni 21

Procedurat për shqyrtimin e ankesave

1. Nëse palët e interesuara vlerësojnë se organi publik ka cenuar të drejtën e tyre për njoftim dhe konsultim publik, sipas parashikimeve të pikës 1, të nenit 6, të këtij ligji, si dhe kur nuk janë respektuar afatet e parashikuara në nenet 15 dhe 17 të këtij ligji, mund të ankohen:

a) pranë titullarit të organit publik përgjegjës për procesin e njoftimit dhe konsultimit publik, kur projektakti nuk është miratuar ende;

b) pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, brenda 30 ditëve nga data e miratimit të aktit.

2. Organi publik përgjegjës, me marrjen e ankesës, merr masa të menjëhershme për korrigjimin dhe reflektimin e vërejtjeve të paraqitura në ankesën e palës së interesuar. Në çdo rast, autoriteti publik njofton palën e interesuar për masat e marra dhe e fton të japë komentet dhe rekomandimet për projektaktin.

3. Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, me marrjen e një ankesë, i kërkon ankuesit dhe organit publik, kundër të cilit është bërë ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim brenda 10 ditëve. Kur e sheh të përshtatshme, Komisioneri organizon një seancë dëgjimore publike me pjesëmarrjen e palëve.

4. Në përfundim të shqyrtimit, Komisioneri, kur arrin në përfundimin që ka shkelje të dispozitave të këtij ligji, i propozon organit publik përgjegjës marrjen e masave administrative ndaj personit/personave përgjegjës, sipas legjislacionit për shërbimin civil në fuqi.



KREU VI
DISPOZITAT KALIMTARE DHE
PËRFUNDIMTARE

Neni 22

Dispozita përfundimtare

Ngarkohet Këshilli i Ministrave për nxjerrjen e akteve të nevojshme nënligjore në zbatim të pikës 2, të nenit 7, të këtij ligji, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e tij.

Neni 23

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 6 muaj pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 30.10.2014

Shpallur me dekretin nr. 8793, datë 18.11.2014 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

LIGJ
Nr. 147/2014

**PËR SHËRBBIMIN E URGJENCËS
MJEKËSORE**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi i ligjit

Ky ligj ka për qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nëpërmjet rregullimit ligjor të shërbimit të urgjencës mjekësore.

Neni 2

Objekti

Ky ligj përcakton parimet kryesore, rregullat e organizimit, mënyrën e funksionimit e të financimit të shërbimit të urgjencës mjekësore në Republikën e Shqipërisë.

Neni 3
Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Urgjenca” është ndryshimi i menjëhershëm i gjendjes shëndetësore që, në rast të mungesës së ofrimit të shërbimit të shpejtë shëndetësor, rrezikon jetën ose dëmton seriozisht shëndetin e personit.

2. “Shërbimi i urgjencës mjekësore” është një sistem i bashkërenduar i burimeve njerëzore, i infrastrukturës dhe i pajisjeve mjekësore, përmes të cilave mundësohet ndihmë dhe kujdes mjekësor i shpejtë dhe i sigurt për personat që pësojnë përkeqësim të menjëhershëm të gjendjes shëndetësore, dëmtime apo sëmundje të papritura.

3. “Autoambulancë” është një mjet lëvizës tokësor, ajror ose detar, i pajisur me shtretër, që shërben dhe mirëmbahet, me qëllim që të sigurojë shërbim urgjence dhe transport të pacientit.

4. “Autoambulancë për shpëtimin e avancuar të jetës” është një automjet që shërben në terren dhe mirëmbahet për të transportuar pacientë dhe punonjës të urgjencës mjekësore, të pajisur me pajisje mjekësore, me qëllim që t’i sigurojë pacientit një shërbim urgjence të avancuar (përfshirë reanimimin e pacientit).

5. “Shërbimi i urgjencës spitalore” është një strukturë e veçantë e spitalit, e cila ka mundësi të sigurojë kujdes mjekësor të specializuar për pacientin në situata urgjente.

6. “Njësi e koordinimit të urgjencave” është njësi që ka të organizuar sistemin e identifikimit dhe të marrjes së informacionit, që përdor telefonin publik apo çdo teknologji tjetër bashkëkohore në këtë aspekt, duke synuar të finalizojë dhënien e shërbimit më të përshtatshëm të urgjencës mjekësore. Kjo njësi identifikon natyrën e kërkesës, përparësinë e saj, sipas shkallës së rrezikut që paraqet, dhënien e udhëzimeve për telefonuesin, shpërndarjen dhe bashkërendimin e burimeve të nevojshme për dhënien e ndihmës mjekësore.

7. “Dhënës i ndihmës së parë mjekësore” ose “DHNPM” është një individ, vullnetar ose jo, i cili është i certifikuar nga struktura përgjegjëse për këtë qëllim.



8. “Transport i urgjencës (TU)” është transporti i një personi për në qendrën shëndetësore ose prej saj, i cili, për shkak të kushteve shëndetësore, kërkon vlerësim mjekësor, monitorim ose trajtim gjatë transportit.

9. “Drejtues i mjeteve të transportit të urgjencës” është një individ i certifikuar nga Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore për të drejtuar mjetin dhe për të kryer aktivitete të tjera të lidhura me urgjencën.

10. “Rrjeti i sistemit të telemjekësisë” është përdorimi i telekomunikacionit dhe teknologjisë informuese për të siguruar kujdes mjekësor në distancë, nëpërmjet transmetimit të informacionit mjekësor dhe imazheve të ndryshme, nga pacienti te personeli mjekësor apo ndërmjet personelit mjekësor nga një vend në tjetrin.

Neni 4 Parimet

Shërbimi i urgjencës mjekësore udhëhiqet nga parimet e mëposhtme:

- a) respektimi i të drejtave të pacientëve, sipas legjislacionit në fuqi;
- b) shërbimi i garantuar falas i urgjencës mjekësore në kohën e duhur për shtetasit që konsiderohen në gjendje rrezikshmërie të lartë për jetën, sipas protokolleve të miratuara nga ministri përgjegjës për shëndetësinë;
- c) ofrimi i shërbimit të urgjencës mjekësore në të gjitha nivelet e tij, për të gjithë shtetasit shqiptarë dhe të huaj me banim të përhershëm ose të përkohshëm në Shqipëri, si dhe për çdo shtetas të huaj që është duke kaluar në territorin e Shqipërisë;
- ç) barazi në përfitimin e shërbimit të urgjencës mjekësore pa asnjë diskriminim;
- d) ndërthurja e veprimeve të urgjencës mjekësore me të gjitha emergjencat kombëtare (zjarrfikës, polici).

KREU II ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I SHËRBIMIT TË URGJENCËS MJEKËSORE

Neni 5 Organizimi i shërbimit të urgjencës mjekësore

1. Shërbimi i urgjencës mjekësore është pjesë përbërëse e sistemit të kujdesit shëndetësor, i cili ofrohet i pandërprerë 24 orë në të gjitha nivelet e

ofrimit të kujdesit shëndetësor.

2. Shërbimi i urgjencës mjekësore organizohet dhe ofrohet në nivel:

- a) parësor;
- b) spitalor;
- c) spitalor universitar;
- ç) spitali universitar të traumës.

3. Në të gjitha nivelet e shërbimit të urgjencës mjekësore ofrohet shërbim me standarde të miratuara me urdhër të ministrit përgjegjës për shëndetësinë. Këto standarde përcaktojnë infrastrukturën fizike, barnat dhe pajisjet mjekësore, si dhe burimet njerëzore të nevojshme për ofrimin e këtij shërbimi.

4. Shërbimi i urgjencës mjekësore në strukturat shëndetësore private zbaton standardet shëndetësore të përcaktuara në këtë ligj dhe në aktet nënligjore në zbatim të tij. Ngritja e shërbimit të urgjencës në strukturat private bëhet sipas legjislacionit shqiptar në fuqi për licencimin.

5. Të gjitha shërbimet e urgjencës mjekësore në strukturat private raportojnë periodikisht pranë Qendrës Kombëtare të Urgjencës Mjekësore, bazuar në kërkesat e Regjistrimit Kombëtar të Urgjencës Mjekësore.

6. Shërbimet e urgjencës mjekësore në strukturat private, në rastet e emergjencave civile, bashkëpunojnë me ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë për zbatimin e Planit Kombëtar të Emergjencave Shëndetësore dhe veprojnë në bazë të planeve të tyre të emergjencave shëndetësore, të miratuara në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë.

Neni 6 Përgjegjësitë e shërbimit të urgjencës mjekësore

Shërbimi i urgjencës mjekësore është përgjegjës për:

- a) ofrimin cilësor të shërbimit në kujdesin parësor, spitalor, trajtimin dhe transportin me autoambulancë për në urgjencën spitalore;
- b) ofrimin e ndihmës së parë për çdo person në kushtet e urgjencës mjekësore, duke filluar nga vendi i ngjarjes;
- c) sigurimin e kujdesit mjekësor të specializuar për çdo person në kushtet e urgjencës mjekësore;
- ç) sigurimin e ndihmës së parë dhe kujdesit mjekësor të specializuar në raste të emergjencave shëndetësore dhe civile;



d) sigurimin e transportit tokësor, ajror dhe ujor të përshtatshëm për shpëtimin e jetës, ofrimin e kujdesit shëndetësor në kushtet e urgjencës mjekësore dhe transferimin në strukturat e specializuara.

Neni 7

Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore (QKUM)

1. Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore (QKUM) është institucioni përgjegjës për zhvillimin e sistemit të shërbimit të urgjencës mjekësore, nëpërmjet planifikimit, drejtimit, pjesëmarrjes dhe bashkërendimit të të gjitha aseteve ekzistuese në një sistem mbarëshpëtësor të unifikuar, si dhe bashkërendimin e veprimtarisë me sistemet e ngjashme në vendet fqinje.

2. Struktura organizative e Qendrës Kombëtare të Urgjencës Mjekësore miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 8

Përgjegjësitë e Qendrës Kombëtare të Urgjencës Mjekësore

Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore (QKUM) ka këto përgjegjësi kryesore:

a) siguron trajnim të vazhdueshëm për personelin shëndetësor dhe joshëndetësor, përfshirë këtu trajnimin klinik dhe programe të trajnimit të vazhdueshëm;

b) bashkërendon veprimtarinë me personelin, organizon punën e strukturave dhe përdorimin e pajisjeve, nëpërmjet një sistemi komunikimi qendror, me qëllim:

i) shfrytëzimin e përzgjedhjes së kryer nëpërmjet sistemit telefonik të urgjencës mjekësore, për të identifikuar alternativën më të përshtatshme të urgjencës;

ii) sigurimin e kontakteve me publikun e gjerë nëpërmjet një numri telefoni të vetëm, duke synuar integrimin e sistemit, për përdorimin e numrit telefonik universal evropian 112 të urgjencës;

iii) sigurimin e kontakteve të drejtpërdrejta me personelin, strukturat dhe pajisjet e këtij sistemi, si dhe me sistemet e tjera me të cilat operon urgjenca mjekësore;

iv) përfshirjen e një numri të përshtatshëm të autoambulancave dhe mjeteve të tjera të transportit për të plotësuar nevojat specifike të

shërbimit të sistemit, sipas zonave, duke siguruar që:

- autoambulancat dhe mjetet e tjera plotësojnë kriteret lidhur me vendndodhjen, pajisjen, si dhe elemente të tjera të përcaktuara në këtë ligj dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij;

- drejtuesit e mjetit dhe personeli tjetër që përfshihet në mjetin transportues kanë trajnimin e përshtatshëm dhe përvojën e kërkuar;

c) përfshin një numër të përshtatshëm strukturash lehtësisht të arritshme, të cilat:

i) janë të afta së bashku të sigurojnë shërbim të urgjencës mjekësore në mënyrë të vazhdueshme;

ii) plotësojnë standardet lidhur me kapacitetet, vendndodhjen, personelin dhe pajisjet;

iii) janë të bashkërenduara me strukturat e tjera të sistemit të kujdesit shëndetësor;

ç) siguron, sipas nevojave, transferimin e pacientëve në institucione që ofrojnë ndjekje shëndetësore dhe rehabilitim, kur është e nevojshme të arrihet rikuperimi maksimal për pacientët;

d) siguron përdorim efektiv të personelit të duhur, pajisjeve dhe aparaturave në çdo njësi që ofron shërbim të urgjencës mjekësore;

dh) siguron shërbim të urgjencës mjekësore për të gjithë pacientët që kërkojnë shërbime urgjence;

e) certifikon paramedikalët, dhënësit e ndihmës së parë dhe personelin ndihmës të Urgjencës mjekësore për dhënien e ndihmës së parë dhe procedurat përkatëse, sipas kurrikulave të miratuara me urdhër të përbashkët nga ministri përgjegjës për arsimin dhe ministri përgjegjës për shëndetësinë;

ë) siguron një sistem të standardizuar për mbledhjen e të dhënave të pacientit që mbulon të gjitha hallkat e sistemit;

f) siguron në zonën që sistemi mbulon me shërbim programe të informimit dhe edukimit të publikut në mënyrë që ai të dijë të vlerësojë mënyrën e marrjes së shërbimit të urgjencës mjekësore;

g) kryen rishikim periodik dhe të gjithanshëm të shtrirjes dhe cilësisë së shërbimit të urgjencës mjekësore;

gj) siguron që shërbimi i urgjencave mjekësore, gjatë katastrofave dhe situatave të dëmtimeve në masë, është i aftë të ofrojë shërbim në një zonë të caktuar;

h) ushtron kontrollin e brendshëm të strukturave të shërbimit të urgjencës mjekësore;



i) mban Regjistrin Kombëtar të Urgjencës Mjekësore në Shqipëri, sipas formatit dhe përcaktimeve të bëra me vendim të Këshillit të Ministrave;

j) përgatit raportin vjetor për ecurinë e punës së shërbimit të urgjencës mjekësore, i cili i paraqitet ministrit përgjegjës për shëndetësinë.

Neni 9

Njësia e koordinimit të urgjencave mjekësore

1. Njësia e koordinimit të urgjencave mjekësore është pjesë e Qendrës Kombëtare të Urgjencës Mjekësore, e cila bashkërendon komunikimin e të gjithë sistemit të komandë - kontrollit të urgjencave mjekësore.

2. Njësia e koordinimit të urgjencave mjekësore komunikon dhe kontrollon të gjithë sistemin e radiove, telefonave etj. të shërbimit kombëtar të urgjencës mjekësore pavarësisht se ku ndodhen ato gjeografikisht në territorin e vendit.

3. Njësia e koordinimit të urgjencave mjekësore kontaktohet nga çdo individ apo institucion, në rast të kërkimit të ndihmës së shpejtë mjekësore, nëpërmjet numrit unik telefonik për gjithë Shqipërinë. Njësia ka për detyrë që, nëpërmjet operatorëve të trajnuar dhe programeve kompjuterike (*software*), të bëjë vlerësimin e çdo komunikimi, të dërgojë mjetin e transportit të urgjencës mjekësore përkatëse dhe të bashkërendojë punën me strukturën pritëse, sipas gjykimit të dhënë gjatë procesit të vlerësimit për rastin në fjalë. Njësia ka për detyrë të regjistrojë të gjitha komunikimet individuale apo transmetimet për të gjithë infrastrukturën shëndetësore, sipas përcaktimeve të bëra me urdhër të ministrit përgjegjës për shëndetësinë.

4. Nëpërmjet sistemit VCS (*voice communication center*) sigurohet ndërlidhja me të gjitha rrugët e komunikimit me radio VHF (helikopterët), UHF (autoambulancat), si dhe PSTN (rrjeti telefonik GSM apo fiks).

Neni 10

Sistemi i komandë - kontrollit dhe përgjigja ndaj urgjencave

1. Sistemi i komandë - kontrollit është sistemi i komunikimit të urgjencës mjekësore, administrimit të personelit, i shërbimeve dhe mjeteve të shërbimit

të urgjencës mjekësore, që shërben për të arritur efektivitetin dhe profesionalizmin si për pacientin, ashtu edhe për personelin mjekësor.

2. Sistemi i komandë - kontrollit shtrihet vertikalisht dhe horizontalisht në tërë sistemin e urgjencës mjekësore.

3. Shërbimi i urgjencës mjekësore përdor një numër telefoni unik, 112, të cilin e promovon në publik. Thirrja kalon automatikisht nga çdo kompani telefonike në vend, fikse dhe celulare, në njësinë e koordinimit të urgjencave mjekësore. Ky numër është falas për popullatën.

4. Shërbimi i urgjencës mjekësore, për nevoja të veta, bashkëpunon me rrjetin e sistemit të telemjekësisë.

5. Përcaktimi i përparësisë së urgjencës në përgjigje të telefonatave bazohet në protokollet përkatëse, sipas urgjencës dhe shkallës së rëndësisë së gjendjes së pacientit, duke synuar një përgjigje të shpejtë ndaj urgjencave që kërcënojnë jetën, për të arritur në një numër sa më të madh të jetëve të shpëtuar.

6. Ministri përgjegjës për shëndetësinë, me urdhër, në varësi të shpërndarjes gjeografike dhe infrastrukturës, përcakton kategorizimin e zonave dhe intensitetin e kohës së përgjigjes ndaj thirrjes për ndihmë mjekësore si dhe përcakton kodifikimin e çdo urgjence mjekësore sipas rëndësisë së gjendjes së pacientit.

Neni 11

Marrëdhëniet me të tretët

1. Shërbimi i urgjencës mjekësore në të gjitha nivelet e organizimit të tij bashkëpunon me struktura të tjera të lidhura me emergjencat, si:

a) Drejtorinë e Përgjithshme të Emergjencave Civile;

b) Policinë e Shtetit;

c) shërbimin zjarrfikës;

ç) Kryqin e Kuq;

d) organizata jofitimprurëse;

dh) shërbimet e urgjencës në rajon dhe në Europë.

2. Bashkëpunimi i ndërsjellë i shërbimeve të urgjencës bëhet për:

a) ofrimin e shërbimit të urgjencës në të gjithë territorin e vendit, sa më të shpejtë dhe cilësor që të jetë e mundur;

b) përfitim në shkëmbimin e përvojave si brenda vendit dhe në rajon;



c) përballimin e emergjencave civile.

3. Mënyra e bashkëpunimit me partnerët jofitimprurës në fushën e urgjencës mjekësore përcaktohet me urdhër të ministrit përgjegjës për shëndetësinë.

4. Çdo organizatë jofitimprurëse, që operon në fushën e urgjencës mjekësore, pajiset me autorizimin përkatës nga ministri përgjegjës për shëndetësinë, i cili përcakton mjetet, personelin, shkallën e ofrimit të shërbimit dhe zonën e mbulimit. Operatori jofitimprurës në fushën e urgjencës mjekësore raporton periodikisht për veprimtarinë e tij të urgjencës mjekësore pranë Qendrës Kombëtare të Urgjencës Mjekësore.

Neni 12

Shërbimi i urgjencës mjekësore në kujdesin parësor

1. Shërbimi i urgjencës mjekësore në kujdesin parësor organizohet në qendrat shëndetësore.

2. Ministri përgjegjës për shëndetësinë miraton hartën e shpërndarjes, standardet e infrastrukturës ndërtimore, pajisjeve mjekësore dhe të burimeve njerëzore të shërbimit të urgjencës në kujdesin parësor.

3. Autoritetet e pushtetit vendor, në bashkëpunim me strukturat lokale të shëndetësisë, janë përgjegjëse për zhvillimin e veprimtarisë së shërbimit të urgjencës në kujdesin parësor për zonën që mbulojnë.

4. Veprimtaria themelore e shërbimit të urgjencës mjekësore në kujdesin parësor ka të bëjë me:

- a) përgjigjen e shpejtë në thirrje;
- b) dhënien e ndihmës së parë;
- c) trajtimin e pacientëve në vendin e ngjarjes.

Neni 13

Shërbimi i transportit

1. Shërbimi i transportit është sektor i urgjencës mjekësore që merret me ndihmën dhe transportin e pacientëve të sëmurë apo të lënduar.

2. Shërbimi i transportit duhet të plotësojë të gjitha standardet e miratuara nga ministri përgjegjës për shëndetësinë për transportin urgjent të pacientëve.

3. Shërbimi i transportit është publik ose i kontraktuar nga operatorë privatë, sipas legjislacionit në fuqi për koncesionet dhe partneritetin publik privat.

Faqe | 9198

4. Drejtuesi i mjeteve të transportit të shërbimit të urgjencës mjekësore duhet të trajnohet për kushtet e mirëmbajtjes, sigurimin nga aksidentet, komunikimin, sipas rregullave të miratuara me urdhër të ministrit përgjegjës për shëndetësinë.

5. Autoambulancat dhe mjetet e tjera ajrore dhe detare të shërbimit të urgjencës mjekësore operojnë kryesisht për qëllime të vlerësimit mjekësor, monitorimit, trajtimit dhe transportit të pacientëve që janë në kushtet e urgjencës mjekësore.

6. Ministri përgjegjës për shëndetësinë miraton me urdhër nivelin standard për pajisjet mjekësore, listën e medikamenteve dhe personelin mjekësor në dispozicion të autoambulancës dhe të mjeteve të tjera ajrore dhe detare të urgjencës mjekësore.

Neni 14

Shërbimi i urgjencës spitalore

1. Shërbimi i urgjencës spitalore përbëhet nga rrjeti i shërbimeve të urgjencës në spitalet rajonale dhe universitare, si dhe nga rrjeti i shërbimeve të urgjencës 24-orëshe në spitalet bashkiake.

2. Spitali rajonal dhe spitali universitar organizojnë shërbimin e urgjencës spitalore, sipas përcaktimeve të bëra me urdhër të ministrit përgjegjës për shëndetësinë.

3. Shërbimi i urgjencës spitalore siguron ekzaminim të hollësishëm mjekësor të të gjithë personave që paraqiten në gjendje emergjente, sipas protokolleve përkatëse, stabilizimin e tyre të plotë brenda mundësive dhe kapaciteteve të institucionit, si dhe transferimin në spitalin përkatës apo në shërbimin e urgjencës spitalore universitare.

4. Shërbimi i urgjencës spitalore zbaton protokollin standard të urgjencës mjekësore, të miratuar nga ministri përgjegjës për shëndetësinë. Ky protokoll përcakton nevojat e shërbimit të urgjencës spitalore në varësi të:

- a) popullatës që mbulon;
- b) faktorëve demografikë;
- c) numrit të pacientëve të asistuar në ditë;
- ç) distancës midis shërbimeve.

5. Shërbimi i urgjencës spitalore në një institucion spitalor duhet të presë të gjitha rastet mjekësore dhe kirurgjikale të referuara nga njësi e koordinimit të urgjencave ose të vetëreferuara. Për rastet e vetëreferuara pas ofrimit të ndihmës mjekësore raportohet pranë njësisë së koordinimit të urgjencave.



6. Shërbimi i urgjencës spitalore duhet të ketë akses sa më të mirë me shërbimin e radiologjisë dhe sallave të operimit. Standardi infrastrukturor ndërtimor, i pajisjeve mjekësore dhe lista e medikamenteve të nevojshme përcaktohen me urdhër të ministrit përgjegjës për shëndetësinë.

Neni 15

Koha e vlerësimit të pacientit

1. Me mbërritjen në shërbimin e urgjencës spitalore, pacientit i përcaktohet shkalla e përparësisë brenda 15 minutave, që është koha maksimale e pritjes për t'u vlerësuar nga mjeku i shërbimit, në bazë të protokolleve të paracaktuara, të miratuara nga ministri përgjegjës për shëndetësinë.

2. Gjatë kalimit nga shërbimi i urgjencës spitalore, regjistrimi deri te vlerësimi dhe trajtimi i pacientit, spitali garanton sigurinë për punonjësit e tij gjatë kryerjes së punës së tyre.

Neni 16

Spitali Universitar i Traumës

1. Spitali Universitar i Traumës është institucioni në varësi të ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë që ofron shërbimin e urgjencës mjekësore në nivelin më të lartë të saj.

2. Spitali Universitar i Traumës ofron shërbimet kirurgjikale dhe jokirurgjikale të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Spitali Universitar i Traumës ka në dispozicion të paktën një sallë operimi të pajisur tërësisht me personel të disponueshëm 24 orë në ditë.

4. Ministri përgjegjës për shëndetësinë miraton protokollin e koordinimit për pranimin dhe transferimin e pacientëve.

5. Spitali Universitar i Traumës ka një shesh për ulje të helikopterit.

6. Spitali Universitar i Traumës duhet të hartojë, të testojë dhe të rishikojë herë pas here planin e përgatitjes e të përgjigjes ndaj katastrofave dhe të menaxhimit të plagosjeve masive, në përputhje me platformën e ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë për përgatitjen dhe përgjigjen ndaj emergjencave.

KREU III

PROFESIONISTËT E SHËRBIMIT TË URGJENCËS MJEKËSORE

Neni 17

Profesionistët dhe punonjësit e shërbimit të urgjencës mjekësore

Profesionistët dhe punonjësit e shërbimit të urgjencës janë mjekët, infermierët, psikologët dhe punonjësit ndihmës, të cilët trajnohen për të gjitha urgjencat që kërcënojnë jetën e që përdorin pajisjet në dispozicion, sipas standardeve të miratuara nga ministri përgjegjës për shëndetësinë.

Neni 18

Personeli shëndetësor në shërbimin e urgjencës spitalore

1. Shërbimi i urgjencës spitalore duhet të ketë punonjës me kohë të plotë.

2. Për 24 orë në 7 ditë të javës duhet të sigurohet minimalisht prezenca e 2 mjekëve, 6 infermierëve dhe 3 personave të personelit ndihmës për autoambulancat.

Neni 19

Mjeku i shërbimit të urgjencës mjekësore

1. Mjeku i shërbimit të urgjencës mjekësore është "Specialist Mjek Urgjence" dhe në mungesë të tyre një mjek i përgjithshëm, i cili ka mbaruar një program specializimi apo trajnimi në urgjencën mjekësore ose kirurgjikale, mjekësinë interne, kardiologji, anestezi-reanimacion, pneumologji.

2. Mjeku i shërbimit të urgjencës mjekësore ka për detyrë:

a) të presë, të vlerësojë dhe të trajtojë çdo të sëmurë që paraqitet për kujdes mjekësor në shërbimin e urgjencës, në varësi të shkallës së përparësisë dhe të rëndësisë së problemit që paraqet;

b) zbaton protokollin e vlerësimit dhe të mjekimit të pacientëve të urgjencës;

c) zbaton me rigorozitet rregulloren e institucionit përkatës, të miratuar nga ministri përgjegjës për shëndetësinë.

Neni 20

Infermieri i shërbimit të urgjencës mjekësore

1. Infermier në shërbimin e urgjencës mjekësore është personi i diplomuar si infermier, i cili ka



mbaruar një program kualifikimi në urgjencën mjekësore.

2. Detyrat kryesore të infermierit të shërbimit të urgjencës janë:

a) të kujdeset për pacientët që paraqiten në urgjencë, në varësi të sektorit, (parësor, pritje triazhim, vlerësim-trajtim, observim) në të gjitha hallkat e menaxhimit të tyre dhe të punojë në grup;

b) të zbatojë me përpikëri protokollat e shërbimit të urgjencës të miratuara nga ministri përgjegjës për shëndetësinë;

c) të zbatojë të gjitha detyrat që i caktohen nga shefi i shërbimit, kryeinfermieri dhe personeli mjekësor;

ç) të marrë pjesë në aktivitetet për ngritjen e nivelit tekniko-profesional, në funksion të rritjes së cilësisë së kujdesit ndaj pacientit.

Neni 21

Personeli ndihmës i shërbimit të urgjencës mjekësore

1. Personeli ndihmës është barelëmbajtësi dhe shoferi i kualifikuar i shërbimit të urgjencës mjekësore.

2. Personeli ndihmës ka për detyrë:

a) të sigurojë mirëmbajtjen e përgjithshme të automjeteve dhe pajisjeve të tyre;

b) të zbatojë protokollat e urgjencës mjekësore;

c) të zbatojë me rigorozitet rregulloren e institucionit përkatës të miratuar nga ministri përgjegjës për shëndetësinë.

Neni 22

Paramedikalët

1. Paramedikali është një profesionist shëndetësor, i cili ofron kujdes shëndetësor për të shpëtuar jetë në situata të urgjencës mjekësore, të shkaktuar nga sëmundje ose nga lëndime/trauma që ndodhin në mjedise jashtëspitalore.

2. Paramedikali ka për detyrë të ofrojë ndihmë mjekësore në vendin e ngjarjes, si dhe gjatë transportit për në spital nëse është e nevojshme.

3. Paramedikali duhet të jetë i pranishëm në çdo autoambulancë ose mjet tjetër të shërbimit të urgjencës mjekësore.

4. Kujdesi shëndetësor i ofruar nga paramedikalët përfshin trajtimin dhe shërbimin

diagnostikues. Ky shërbim ofrohet jashtë ambienteve të spitalit ose për raste të veçanta, si trajtimi i lëndimeve, traumave edhe brenda ambienteve të spitalit.

Neni 23

Dhënësit e ndihmës së parë mjekësore

1. Dhënës i ndihmës së parë mjekësore është një individ, vullnetar ose jo, i cili është i certifikuar nga Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore për këtë qëllim.

2. Mënyra e ofrimit të ndihmës së parë mjekësore të dhënësve të ndihmës së parë mjekësore miratohet me urdhër të ministrit përgjegjës për shëndetësinë.

KREU IV

FINANCIMI I URGJENCËS MJEKËSORE

Neni 24

Financimi nga Buxheti i Shtetit

1. Shërbimi i urgjencës mjekësore financohet nga Buxheti i Shtetit dhe nga burime të tjera në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2. Buxheti i shërbimit të urgjencës mjekësore është program i veçantë në buxhetin e miratuar për ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë.

KREU V

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 25

Aktet nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 7, pika 2; 8, shkronja “i”; dhe 16, pika 2.

2. Ngarkohet ministri përgjegjës për shëndetësinë që, brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet normative në zbatim të neneve 5, pika 3; 8, shkronja “e”; 9, pika 3; 10, pika 6; 11, pika 3; 12, pika 2; 13, pikat 2, 4 e 6; 14, pikat 2, 4 e 6; 15, pika 1; 16, pika 5; 17, dhe 23, pika 2.

Neni 26

Shfuqizime

Çdo akt që bie në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji shfuqizohet.



Neni 27

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 30.10.2014

Shpallur me dekretin nr. 8794, datë 18.11.2014 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

LIGJ

Nr. 148/2014

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË KREDISË PËR EKSPORT NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, QË VEPRON NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE I PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCAVE, DHE UNICREDIT BANK AUSTRIA AG PËR FINANCI MIN E PROJEKTIT TË SISTEMIT TË UJËRAVE TË ZEZA TË BILISHTIT, “KONTRATË ME ÇELËSA NË DORË – LOTI 1”

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja e kredisë për eksport ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, që vepron në emër të Republikës së Shqipërisë dhe i përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe UniCredit Bank Austria, AG për financimin e projektit të sistemit të ujërave të zeza të Bilishtit, “Kontratë me çelësa në dorë - Loti 1”, me një hua të butë prej 2 998 856 (dy milionë e nëntëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e tetëqind e pesëdhjetë e gjashtë) eurosh, sipas tekstit bashkëlidhur këtij ligji dhe pjesëve përbërëse të tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 30.10.2014

Shpallur me dekretin nr. 8795, datë 18.11.2014 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

MARRËVESHJE KREDIE EKSPORTI

Hua e Butë nr. 233.258

për një shumë maksimale prej 2, 998, 856.00 euro

datëkorrik 2014

lidhur ndërmjet

Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, që vepron në emër të Republikës së Shqipërisë dhe përfaqësuar nga Ministria e Financave (si “Huamarrës”) dhe UniCredit Bank Austria AG (si “Huadhënës”) në lidhje me financimin e “Projektit të Përfunduar të Sistemit të Ujërave të Zeza Bilisht – Loti 1”.

Kjo marrëveshje kredie eksporti për një hua të butë nr. 233 258 për një shumë maksimale prej 2 998 856.00 euro (“Marrëveshja”) është e datës korrik 2014, e lidhur ndërmjet Huamarrësit të specifikuar në aneksin 1 (Huamarrësi) dhe Huadhënësit (Huadhënësi), të specifikuar në aneksin 1.

1. PËRKUFIZIME

Në këtë Marrëveshje dhe në anekset e saj, shprehjet e mëposhtme kanë kuptimet e mëposhtme: -

“Datë e Pranimi” është data në të cilën kjo Marrëveshje nënshkruhet nga të dyja palët dhe ratifikohet nga Parlamenti i Republikës së Shqipërisë.

“Aneks” është një aneks në këtë Marrëveshje ku termat e këtij aneksi konsiderohen të jenë përfshirë në këtë Marrëveshje dhe përbëjnë pjesë të saj.

“Periudhë e Disponibilitetit” janë afatet e specifikuara në aneksin 3, Huamarrjet e të cilave mund të tërhiqen kundrejt Instrumentit të Kredisë.

“Huamarrje” është një shumë e tërhequr nga Huamarrësi kundrejt Instrumentit të Kredisë.

“Ditë Pune” është një ditë në të cilën bankat janë të hapura për punë dhe veprime dhe



depozita në këmbimin e huaj ndërmjet bankave që mund të kryhen në Vjenë dhe në Tiranë.

“Data e Mbylljes” është data e përkufizuar në seksionin 7.

“Instrument Kredie” është shuma e specifikuar në aneksin 3 kundrejt së cilës Huamarrësi mund të tërheqë Huamarrjet gjatë Periudhës së Disponibilitetit.

“Euro” ose “€”, monedha e vetme e atyre shteteve anëtare të Bashkimit Europian që miratojnë euron si monedhë të tyre në pajtim me legjislacionin e Komunitetit Europian në lidhje me Bashkimin Europian Ekonomik dhe Monetar.

“EURIBOR” është norma ndërbankare e ofruar nga Federata bankare e Bashkimit Europian (ose një person tjetër që merr përsipër administrimin e normës) të vendosur në faqen e EURIBOR-1 të Reuters Screen (ose çdo faqe zëvendësuese Reuters që tregon normën ose faqen përkatëse të një shërbimi informimi që publikon këtë normë herë pas here të Reuters-it, që përcaktohet nga Huamarrësi për ofrimin e depozitave në euro për një periudhë të krahasueshme me Periudhën e Interesit për Huan përkatëse në ose rreth orës 11:00 të Brukselit në Ditën e dytë të Punës para fillimit të kësaj Periudhe Interesi dhe, nëse kjo normë është zero ose poshtë zeros, EURIBOR-i konsiderohet të jetë zero. Kjo normë përcaktohet mbi bazën e një viti me 360 ditë.

“Llogari Instrumenti” është llogaria e hapur në emër të Huamarrësit në pajtim me dispozitat e seksionit 2.3.

“Data e fundit e Pranimit” është data në të cilën Huadhënësi ka marrë nga Eksportuesi i Projektit kopjen e protokollit të fundit të pranimit të aprovuar nga Blerësi i Projektit.

“Datat e Pagesës së Interesit” është 31 marsi, 30 qershori, 30 shtatori dhe 31 dhjetori i çdo viti, me kusht që nëse një datë e tillë nuk është Ditë Pune, referenca në këtë datë është në Ditën e Punës pararendëse.

“Periudhë Interesi” është një periudhë:

- i) që fillon në datën e Huamarrjes ose në ditën e fundit të Periudhës pararendëse të interesit; dhe
- ii) që mbaron më 31 mars, 30 qershor, 30 shtator, 31 dhjetor në çdo vit

“Barrë” është çdo hipotekë, rëndim, peng, barrë, hipotekim, mbajtje titulli ose një interes

tjetër garancie të çdo lloji, pavarësisht nga mënyra e lindjes.

“Hua” do të thotë shuma e përgjithshme principale e Huamarrjeve të dhëna sipas Instrumentit të Kredisë dhe për kohën e mbetur.

“Datat e Shlyerjes së Detyrueshme” do të thotë datat në çdo vit, të specifikuara në aneksin 3, me kusht që nëse një datë e tillë nuk është Ditë Pune, referenca në këtë datë është në Ditën e Punës pararendëse.

“OeKB” do të thotë Oesterreichische Kontrollbank Aktiengesellschaft, Am Hof 4, 1011 Vienna, Austria, që vepron si Agjenci Kredie Eksporti për dhe në emër të Republikës së Austrisë.

“Garanci e OeKB-së” është një Garanci nr. 233 258 e lëshuar nga OeKB-ja në lidhje me instrumentin e Kredisë për dhe në emër të Republikës së Austrisë në pajtim me Ligjin e Promovimit të Eksportit të vitit 1981, të ndryshuar.

“Procedurë Pagese” është procedura për pagesën e Huamarrjeve, të specifikuara në aneksin 4.

“Projekti” është Projekti i specifikuar në aneksin 2.

“Blerësi i Projektit” është Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Tiranë, Republika e Shqipërisë, e përcaktuar në aneksin 2.

“Eksportuesi i Projektit” është STRABAG AG, Spittal a.d. Drau, Austria, i specifikuar në aneksin 2.

“Marrëveshje e Blerjes” është marrëveshja në lidhje me Projektin e lidhur ndërmjet Eksportuesit të Projektit dhe Blerësit të Projektit dhe e specifikuar në aneksin 2.

“Seksion” do të thotë seksion i kësaj Marrëveshjeje.

2. INSTRUMENTI I KREDISË

2.1 Preambulë

Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje është përcaktimi i termave dhe kushteve sipas të cilave Huadhënësi do të financojë 100% të vlerës së përgjithshme të kontratës (por deri në një shumë maksimale të specifikuar si “Instrumenti i Kredisë” në aneksin 3) që duhet të paguhet nga Blerësi i Projektit Eksportuesit të Projektit sipas Marrëveshjes së Blerjes.

2.2 Instrumenti i Kredisë

Huadhënësi bie dakord t'i ofrojë Huamarrësit Instrumentin e Kredisë gjatë Periudhës së



Disponibilitetit sipas termave dhe kushteve të parashikuara në këtë Marrëveshje, me kusht që një Huamarrje mund të bëhet nga Huamarrësi sipas Instrumentit të Kredisë në pajtim me Procedurën e Pagesës së specifikuar në aneksin 4 dhe zbatohet kundrejt pagesës që i kërkohet Eksportuesit të Projektit sipas Marrëveshjes së Blerjes.

Kredia e dhënë jepet sipas dhe në bazë të dispozitave të rregullave dhe rregulloreve për kreditë e eksportit të shpallura nga Republika e Austrisë. Huamarrësi vëren që financimi mbështetet nga fondet e ndihmës publike me një element granti prej 35,30 % (tridhjetë e pesë pikë tridhjetë për qind).

Huadhënësi mund të refuzojë disbursimin e një Huamarrjeje nëse një Huamarrje e tillë dhe interesi i saj nuk do të mbulohej nga garancia e dhënë nga OeKB-ja për dhe në emër të Republikës së Austrisë në pajtim me Aktin e Promovimit të Eksportit, i ndryshuar, dhe/ose marrëveshja e financimit me OeKB-në për Instrumentin e Kredisë pushon së qeni në fuqi.

2.3 Llogaria e Instrumentit

Huadhënësi hap një llogari instrumenti në euro në emrin e Huamarrësit, të përcaktuar si “Llogaria e Instrumentit”. Çdo Huamarrje debitohet nga Llogaria e Instrumentit, në pajtim me këtë Marrëveshje, vlerën dhe datën e pagesës së kësaj Huamarrjeje. Shlyerjet dhe Parapagimet zbatohen përkatësisht në Llogarinë e Instrumentit.

2.4 Pavarësia e Marrëveshjes dhe Marrëveshja e Blerjes

Kjo Marrëveshje dhe Marrëveshja e Blerjes janë marrëveshje të veçanta dhe të pavarura. Asnjë mospërbushje e detyrimeve të Eksportuesit të Projektit sipas Marrëveshjes së Blerjes nuk ndikon mbi detyrimet e Huamarrësit kundrejt Huadhënësit, dhe Huadhënësi nuk është përgjegjës për asnjë mosveprim të Eksportuesit të Projektit dhe/ose një pale tjetër në Marrëveshjen e Blerjes.

3. INTERESI

3.1 Interesi për Llogarinë e Instrumentit

Huamarrësi paguan interesin në Datat e Pagesës së Interesit me një normë të përcaktuar sipas specifikimit në aneksin 3, të llogaritur mbi shumën e kredisë së pashlyer.

3.2 Llogaritja dhe Data e Pagesës së Interesit

Interesi i kërkueshëm në pajtim me seksionin 3.1 mblihet nga dita në ditë, llogaritet mbi bazën e numrit faktik të ditëve të kaluara për periudhën përkatëse të interesit dhe një viti me 360 ditë, dhe, përveç kur parashikohet ndryshe në seksionin 6.1, i paguhet në fund të çdo semestri nga Huamarrësi Huadhënësit në Datat e Pagesës së Interesit.

3.3 Kamatëvonesa

Në rastin e moskryerjes nga Huamarrësi të pagesave në datën e kërkueshme të një shume të kërkueshme, Huamarrësi paguan interes për këtë shumë nga data e moskryerjes deri në datën e pagesës faktike të normës së specifikuar në aneksin 3. Kamatëvonesa sipas seksionit 3.3 është i kërkueshëm në Datat e Pagesës së Interesit.

4. TARIFA DHE SHPENZIME

4.1 Tarifa e Zotimit Financiar

Për periudhën që fillon në Datën e Mbylljes dhe që përfundon në fund të Periudhës së Disponibilitetit, Huamarrësi i paguan Huadhënësit një tarifë në normën e specifikuar në aneksin 3. Tarifa e Zotimit Financiar e kërkueshme në pajtim me këtë seksion 4.1 llogaritet mbi bazën e numrit faktik të ditëve që kanë kaluar dhe një viti me 360 ditë nga Huadhënësi mbi balancën e patërhequr të Instrumentit të Kredisë në fillimin e çdo semestri kalendarik dhe paguhet në fund të çdo periudhë nga Huamarrësi Huadhënësit në Datat e Pagesës së Interesit. Paga e parë e tarifës së zotimit financiar bëhet në Datën e parë të Pagesës së Interesit pas Datës së Mbylljes.

4.2 Tarifa e Menaxhimit

Huamarrësi, brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas Datës së Mbylljes (por jo më vonë se 5 Ditëve Pune para disbursimit të parë të Instrumentit të Kredisë) i paguan Huadhënësit tarifën e Menaxhimit të specifikuar në aneksin 3.

4.3 Shpenzimet

i) Për më tepër, Huamarrësi i paguan Huadhënësit me kërkesë shpenzimet e arsyeshme dhe të dokumentuara (duke përfshirë shpenzimet juridike, të përkthimit dhe udhëtimit dhe shpenzimet në lidhje me garancinë e OeKB-së) të shkaktuara nga Huadhënësi në rastin e paditjes ose kompensimit të shumës së kërkueshme nga Huadhënësi.



ii) Të gjitha taksat, detyrimet shpenzimet dhe detyrime të tjera që i ngarkohen Huadhënësit nga Ministria e Financave të Shqipërisë ose një autoritet tjetër shqiptar në lidhje me këtë Marrëveshje dhe transaksionet e parashikuara në të janë në llogari të Huamarrësit dhe të pagueshme nga Huamarrësi Huadhënësit.

4.4 Primi i Garancisë së OeKB-së

Sipas Marrëveshjes Huadhënësi i ngarkon Huamarrësit një kompensim për primin e garancisë së OeKB-së në mënyrën e mëposhtme:

i) Primi i Garancisë së OeKB-së dhe Tarifa e Trajtimit të OeKB-së së pagueshme në fillim

Huamarrësi, brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas Datës së Mbylljes (por jo më vonë se 5 Ditëve Pune para disbursimit të parë të Instrumentit të Kredisë) i paguan Huadhënësit qysh në fillim pjesën e kompensimit të primit të garancisë të OeKB-së dhe tarifën e Menaxhimit të specifikuar në aneksin 3 në shumat e specifikuar në aneksin 3.

ii) Primi i Garancisë së OeKB-së e pagueshme si Marzh

Duke filluar me Datën e Pagesës së Interesit që bie pas Datës së Mbylljes, Huamarrësi i paguan Huadhënësit kompensimin për primin e garancisë të OeKB-së të pagueshme si marzh sipas specifikimit në aneksin 3. Marzhi i primit të garancisë së OeKB-së është i kërkueshëm dhe i pagueshëm në çdo semestër në Datat e Pagesës së Interesit.

Grafiku i pagesës së shumave që duhet të paguhet sipas seksionit 4.4 përcaktohet në garancinë përfundimtare të lëshuar nga OeKB-ja. Huadhënësi informon Huamarrësin për lëshimin e garancisë dhe grafikun e pagesës përkatësisht dhe ky njoftim bëhet pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshjeje.

Nëse gjatë afatit të Marrëveshjes së Kredisë së Eksportit primi i garancisë së OeKB-së rritet, për shkak se: i) vlerësimi i riskut tregtar të bërë nga OeKB-ja në lidhje me lëshimin e garancisë së OeKB-së ka ndryshuar; ose ii) ndryshimet thelbësore në termat kontraktuale të Marrëveshjes së Kredisë së Eksportit janë miratuar, Huamarrësi rimbursion Huadhënësin me kërkesë për këtë rritje.

5. SHLYERJA

5.1 Shlyerja e Detyrueshme

Huaja e mbetur në fund të Periudhës së Disponibilitetit shlyhet nga Huamarrësi në këtë

numër të kësteve të barabarta gjysmëvjetore të shlyerjes në Datat e Shlyerjes së Detyrueshme të specifikuar në aneksin 3. Huamarrësi, brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve kalendarike pas Datës së Pranimit Provizor i njofton Huamarrësit listën e Datave të Shlyerjes së Detyrueshme dhe shumat e kërkueshme në çdo datë të tillë.

5.2 Shlyerja Opsionale

Huamarrësi mund të shlyejë të gjithë ose një pjesë (nëse pjesërisht, në shumën e përcaktuar në aneksin 3 ose në pjesë përbërëse të saj) të Huas pas një njoftimi me shkrim prej të paktën tridhjetë (30) ditësh (ky njoftim është i pakthyeshëm) për datën e propozuar të parapagimit drejtuar Huadhënësit duke iu nënshtruar aprovimit të OeKB-së dhe pagesës së shpenzimeve shtesë të bëra nga Huadhënësi. Çdo parapagesë e tillë, nëse bëhet gjatë Periudhës së Disponibilitetit, e zvogëlon shumën e Instrumentit të Kredisë me një shumë të barabartë me këtë parapagesë. Çdo referencë tek Instrumenti i Kredisë në këtë Marrëveshje konsiderohet të jenë referenca në shumat e zvogëluara dhe të specifikuar në aneksin 3. Çdo parapagesë e tillë, nëse bëhet pas skadimit të Periudhës së Disponibilitetit, zbatohet për të zvogëluar me shuma të barabarta këstet e shlyerjes së mëvonshme.

6. PAGESAT

6.1 Njoftimi i Pagesës

Jo më vonë se tridhjetë (30) ditë kalendarike para çdo Date të Pagesës së Interesit, sipas rastit, Datës së Shlyerjes së Detyrueshme, Huadhënësi njofton Huamarrësin për këto shuma që janë të kërkueshme për t'iu paguar nga Huamarrësi Huadhënësit në pajtim me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje në lidhje me principalin, interesin dhe tarifën e zotimit financiar, me kusht që moskryerja e njoftimit si më sipër nuk e liron Huamarrësin nga detyrimi i tij për të bërë pagesat e këtyre shumave të mësipërme kur bëhen të kërkueshme.

Njoftimi specifikon, gjithashtu, për çdo pagesë që duhet të bëhet sipas kësaj Marrëveshjeje, shumën e saktë dhe qëllimin e pagesës (përvetësimin e shumave të kërkueshme dhe të pagueshme të njoftuara nga Huadhënësi) dhe Huamarrësi kryen pagesën në mënyrën e këshilluar dhe konfirmon zbatimin e fondeve me shkrim. Huamarrësi këshillon Huadhënësin me



shkrim për qëllimin e pagesës (përvetësimi i fondeve) për çdo shumë që i paguhet Huadhënësit. Nëse nuk merret ndonjë informacion i tillë, zbatohet seksioni 6.6.

Nëse një shumë e caktuar debitohet dhe/ose kreditoret në Llogarinë e Instrumentit dhe/ose një llogari tjetër që mund të hapet në lidhje me këtë Marrëveshje në çdo kohë brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve kalendarike para Datës së Pagesës së Interesit, interesi ose çdo shumë tjetër e kërkueshme në lidhje me të në Datën e Pagesës së Interesit mbartet dhe bëhet e kërkueshme dhe e pagueshme Huadhënësit në Datën pasuese të Pagesës së Interesit, përkatësisht rillogaritit (në rastin e shumave të kredituara) për Datën pasuese të Pagesës së Interesit.

6.2 Mënyra e Pagesës

Në çdo Datë të Pagesës së Interesit, Datë të Shlyerjes së Detyrueshme ose datë tjetër të kërkueshme për pagesën e çdo shume të kërkueshme dhe të pagueshme sipas kësaj Marrëveshjeje, sipas rastit, Huamarrësi kryen pagesën e shumave dhe monedhës së kërkueshme në këtë datë nga Huamarrësi sipas kësaj Marrëveshjeje në Vjenë, në vlerën dhe datën e kërkueshme përkatëse.

Të gjitha pagesat nga Huamarrësi drejtuar Huadhënësit të shumave të kërkueshme bëhen në euro lirisht të konvertueshme dhe të transferueshme në Vjenë.

6.3 Heqja Dorë nga Kompensimi ose Kundërpretendimi

Huamarrësi heq dorë nga të gjitha të drejtat e kompensimit ose kundër-pretendimit që mund të ketë në lidhje me një shumë të kërkueshme nga Huadhënësi dhe bie dakord që nuk do të mbajë pagesa për asnjë arsye të shumave të kërkueshme për pagesë. Veçanërisht Huamarrësi nuk mban pagesën e shumave të kërkueshme nga Huadhënësi sipas kësaj Marrëveshjeje për shkak se ai ka pretendime, të drejtë padie, të drejta ose kërkesa kundrejt Eksportuesit të Projektit ose furnitorëve të tjerë në lidhje me Projektin.

6.4 Pagesat e lira nga Mbajtja e Taksave dhe Detyrimeve të tjera

Të gjitha pagesat që duhet të bëhen nga Huamarrësi sipas kësaj Marrëveshjeje kryhen pa kompensim ose kundërpretendim dhe të lira dhe pa zbritje për ose për llogari të ndonjë tatimi,

detyrimi, zbritjeje, mbajtjeje apo detyrimi tjetër të tashëm ose të ardhshëm të çdo natyre të Republikës së Shqipërisë, përveç kur Huamarrësit i kërkohet të bëjë këto zbritje me ligj. Nëse kjo i kërkohet me ligj, shuma e kërkueshme nga Huamarrësi në lidhje me këtë pagesë rritet në masën e nevojshme për të siguruar që pas bërjes së kësaj zbritjeje të tatimeve, detyrimeve, zbritjeve, mbajtjeve ose detyrimeve të tjera huadhënësi merr në datën e kërkuar për këtë pagesë një shumë neto të barabartë me shumën që do të kishte marrë nëse nuk do të duhej të bëhej kjo zbritje e tatimeve, detyrimeve, zbritjeve, mbajtjeve së detyrimeve të tjera. Huamarrësi i jep menjëherë Huadhënësit çdo faturë, certifikatë ose provë tjetër që provon shumat (sipas rastit) e paguara ose të pagueshme në lidhje me një zbritje apo mbajtje si më sipër.

6.5 Shpenzimet e shtuara

Nëse rezultati i:

- një ndryshimi në, ose prezantimi të një ligji, rregulloreje, kërkesë rregullatore ose një ndryshimi në interpretimin ose zbatimin e tyre; ose

- përmbushjes nga Huadhënësi të një udhëzimi apo kërkesë (pavarësisht nëse ka fuqinë e ligjit apo jo) të një banke qendrore, autoriteti monetar, rregullator ose tjetër;

(duke përfshirë, në çdo rast, pa kufizim, ato në lidhje me mjaftueshmërinë e kapitalit, likuiditetin, sendet pasurore rezervë dhe depozitat e veçanta) është:

a) rrit shpenzimet ose ngarkon shpenzime shtesë për Huadhënësin në marrjen përsipër ose mbajtjen e detyrimit apo financimin e huas; dhe/ose

b) ul shumën e pagueshme ose kthimin faktik të Huadhënësi sipas kësaj Marrëveshjeje; dhe/ose

c) ul normën e Huadhënësit të kthimit në kapitalin e përgjithshëm për shkak të një ndryshimi në mënyrën në të cilën kërkohet të alokojë burimet kapitale sipas detyrimeve në bazë të kësaj Marrëveshjeje; dhe/ose

d) i kërkon Huadhënësit të bëjë një pagesë ose të heqë dorë nga një kthim, ose llogaritit me referencë të një shumë e arkëtuar ose e arkëtueshme sipas kësaj Marrëveshjeje.

Huamarrësi i paguan Huadhënësit me kërkesë çdo shpenzim, zbritje, pagesë ose kthim të pakryer.



Çdo certifikatë e Huadhënësit në lidhje me këto shpenzime, zbritje, pagesë, heqje dorë nga kthimi, në mungesë të gabimeve të dukshme, është përfundimtare dhe detyruese për Huamarrësin.

Për qëllimet e kësaj dispozite, Huadhënësi mund të alokojë ose të shpërndajë shpenzimet dhe/ose humbjet në mirëbesim të sendet e tij pasurore dhe detyrimet e tij (ose një kategori të tyre) mbi atë bazë që e konsideron të përshtatshme.

6.6 Caktimi i Pagesave

Të gjitha pagesat e marra nga Huadhënësi prej Huamarrësit (përveç kur Huadhënësi ndryshon rendin e zbatimit) zbatohen nga Huadhënësi kundrejt pagesës së shumave të kërkueshme në rendin e mëposhtëm, dhe Huamarrësi bie dakord për zbatimin e këtyre pagesave në këtë rend (dhe për çdo ndryshim të kryer nga Huadhënësi):

- a) shumat e kërkueshme sipas seksionit 4.2 dhe 4.3 (Tarifa e Menaxhimit dhe Shpenzimet);
- b) shumat e kërkueshme sipas seksionit 4.4 (Primi i Garancisë së OeKB-së);
- c) shumat e kërkueshme sipas seksionit 4.1 (Tarifa e Përkushtimit);
- d) shumat e kërkueshme sipas seksionit 3.3 (Kamatëvonesa);
- e) shumat e kërkueshme sipas seksionit 3.1 (Interesi);
- f) shumat e kërkueshme sipas seksionit 5.1 (Shlyerja e Detyrueshme);
- g) shumat e kërkueshme sipas seksionit 3.1 (Interesi);
- h) shumat e kërkueshme sipas seksionit 5.1 (Shlyerja e Detyrueshme);
- i) shumat e kërkueshme sipas seksionit 5.2 (Parapagesa Opsionale).

Huadhënësi vë në dijeni Huamarrësin në lidhje me çdo aplikim të fondeve. Shumat e prapambetura shlyhen para shumave të kërkueshme. Çdo udhëzim për të kundërtën dhënë Huamarrësit nuk merret në konsideratë.

Huamarrësi pranon që në bazë të garancisë së OeKB-së, OeKB-ja ka rezervuar kundrejt Huadhënësit të drejtën për të ndryshuar përvetësimin e pagesave të caktuara më sipër. Në një rast të tillë, Huadhënësi informon menjëherë Huamarrësin me shkrim dhe Huamarrësi pranon caktimin nga OeKB-ja dhe merr përsipër të shlyeja Huan dhe çdo shumë tjetër të mbetur

sipas kësaj Marrëveshjeje që njoftohet (duke përfshirë një llogaritje të hollësishme të saj) nga Huadhënësi Huamarrësit.

7. PARAKUSHTE

Ky Instrument Kredie bëhet i disponueshëm për Huamarrësin në datën (Data e Mbylljes) kur Huamarrësi merr një njoftim nga Huadhënësi që janë përmbushur ose është hequr dorë nga kushtet e mëposhtme në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Huadhënësin:

i) Huadhënësi duhet të këtë marrë:

a) një kopje të Marrëveshjes së Blerjes të pranueshme në formë dhe përmbajtje për Huadhënësin së bashku me një certifikatë nga Eksportuesi i Projektit në një datë jo më vonë se katërmëdhjetë (14) ditë kalendarike para Datës së Mbylljes, me efektin që Marrëveshja e Blerjes në formën e paraqitur Huadhënësit është në fuqi të plotë (aneksi 6);

b) një mendim nga Ministri i Drejtësisë i Republikës së Shqipërisë i pranueshëm për Huadhënësin me atë përmbajtje që Huadhënësi mund të kërkojë (sipas aneksit 5), së bashku me kopje të certifikuara të çdo pëlqimi ose autorizimi të përmendur në këtë mendim;

c) një kopje të një vendimi të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë që aprovon këtë Marrëveshje në parim;

d) një prokurë e lëshuar nga Kryeministri i Republikës së Shqipërisë që autorizon një person ose persona të specifikuar për të nënshkruar këtë Marrëveshje dhe të gjitha dokumentet dhe njoftimet e tjerë që duhet të nënshkruhen dhe/ose dërgohen në lidhje me këtë Marrëveshje;

e) një kopje origjinale të kësaj Marrëveshjeje të nënshkruar rregullisht nga një person ose disa persona të autorizuar me prokurën e përmendur në paragrafin (d) më sipër;

f) nënshkrimet ekzemplarë të personit ose personave të autorizuar të nënshkruajnë të gjitha dokumentet dhe njoftimet e tjera që i jepen Huadhënësit në emër të Huamarrësit;

g) nënshkrimet ekzemplarë të personit ose personave të autorizuar të nënshkruajnë të gjitha dokumentet dhe njoftimet që i jepen Huadhënësit në emër të Blerësit të Projektit;

h) nënshkrimet ekzemplarë të personit ose personave të autorizuar të nënshkruajnë të gjithë dokumentet dhe njoftimet që i jepen Huadhënësit në emër të "Kontraktuesit" dhe



"Palës së Tretë" që përkufizohet në nënklauzolën 1.1.2.4 të Marrëveshjes së Blerjes;

i) një emërim të një Përfaqësuesi për Huamarrësin në Republikën e Austrisë për Marrëveshjen (aneksi 7);

i) çdo dokument, provë ose autorizim tjetër që mund të kërkojë Huadhënësi për t'i dhënë kësaj Marrëveshjeje dhe transaksioneve të parashikuar në të një fuqi ligjore, të vlefshme, detyruese dhe të ekzekutueshme.

ii) Huadhënësi duhet të këtë marrë:

a) një garanci të lëshuar nga OeKB-ja për dhe ne emër të Republikës së Austrisë në pajtim me Aktin e Nxitjes së Eksportit të vitit 1981, të ndryshuar, termat dhe kushtet e së cilës mund të përmbushen nga Huadhënësi;

b) një marrëveshje rfinansimi me OeKB-në për Huan;

c) një marrëveshje shtesë me Eksportuesin e Projektit dhe aprovimin e autoriteteve të Huadhënësit të kësaj Marrëveshjeje.

iii) Çdo kusht shtesë (sipas rastit) të kërkuar në garancia e Republikës së Austrisë të lëshuar nga OeKB-ja.

Me përmbushjen e të gjitha kushteve të mësipërme, Huadhënësi njofton menjëherë Huamarrësin për këtë qëllim. Nëse këto kushte nuk janë përmbushur ose hequr dorë brenda Periudhës së Mbylljes së specifikuar në aneksin 3, kjo Marrëveshje, pa cenuar detyrimin e Huamarrësit sipas seksionit 4.2, pushon së qeni detyruese për palët.

Secili nga dokumentet dhe njoftimet e përmendura më sipër është në anglisht ose gjermanisht. Nëse nuk është në anglisht ose gjermanisht, këtij dokumenti i bashkëngjitet një përkthim i certifikuar në anglisht.

Kushtet në këtë seksion 7 (Parakushtet) përfshihen vetëm në përfitim të Huadhënësit dhe prej tyre mund të hiqet dorë ose të shtyhen nga Huadhënësi plotësisht ose pjesërisht me ose pa kushte.

8. NGJARJE TË QENIES NË VONESË

8.1 Ngjarje të Qenies në Vonesë

Secila nga ngjarjet e mëposhtme përbëjnë një Ngjarje të Qenies në Vonesë:

a) ka mospagesë për më shumë se katërmëdhjetë (14) ditë kalendarike nga Huamarrësi për principalin, interesin ose shumën të tjera të kërkueshme në lidhje me Huan; ose

b) Huamarrësi nuk përmbush ose nuk respekton ndonjë kusht ose detyrim që gjendet në këtë Marrëveshje të ndryshëm nga pagesa e principalit, interesit ose një shumë tjetër për një periudhë prej tridhjetë (30) ditësh kalendarike nga data më e hershme kur Huamarrësi është vënë në dijeni për moskryerjen dhe data në të cilën Huamarrësit i është dhënë njoftim me shkrim për këtë moskryerje duke iu kërkuar të bëjë ndreqjen nga Huadhënësi; ose

c) çdo garanci ose angazhim i bërë nga Huamarrësi në lidhje me këtë Marrëveshje rezulton se nuk është e vërtetë në një aspekt të rëndësishëm kur është bërë; ose

d) Huamarrësi është në vonesë të pagesës ose përmbushjes së një detyrimi në lidhje me fondet e tërhequra të ndryshme nga Huaja (duke përfshirë në çdo rast detyrimin sipas një garancie); ose

e) një licencë, pëlqim, regjistrim ose aprovim (qeveritar ose tjetër) që kërkohet për vlefshmërinë, ekzekutueshmërinë ose ligjshmërinë e kësaj Marrëveshjeje ose Huan, ose përmbushja e tyre revokohet ose pushon së qeni në fuqi për një arsye të caktuar; ose

f) Republika e Shqipërisë deklaron një moratorium të përgjithshëm për detyrimet e saj për pagesë kundrejt kreditorëve; ose

g) çdo ngjarje që normalisht, sipas mendimit të Huadhënësit ka ndikim të konsiderueshëm negativ në aftësinë e Huamarrësit për të përmbushur detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje; ose

h) garancia e Republikës së Austrisë e lëshuar nga OeKB-ja ose një prej dispozitave të saj revokohet, shfuqizohet ose pushon së qeni në fuqi ose pushon të japë garancinë e synuar ose bëhet e paligjshme për një arsye, ngjarje ose rrethanë të caktuar që mund t'i atribuohet sferës së Huamarrësit.

8.2 Veprimi në rastin e Ngjarjes së Qenies në Vonesë

Nëse ka ndodhur një Ngjarje e Qenies në vonesë dhe kjo vazhdon të ekzistojë, nga Huadhënësi mund të ndërmerret një ose të gjitha veprimet e mëposhtme:

a) Huadhënësi, me njoftim me shkrim drejtuar Huamarrësit, e deklaron principalin dhe interesin e mbledhur në lidhje me Huan dhe të gjitha shumën e pagueshme menjëherë të kërkueshme



dhe të pagueshme, dhe pas kësaj këto bëhen menjëherë të kërkueshme dhe të pagueshme, pa parashtrime, kërkesa, kundërshtime apo një njoftim tjetër të këtij lloji;

b) Huadhënësi, me njoftim me shkrim drejtuar Huamarrësit, e deklaron Instrumentin e Kredisë të shfuqizuar, dhe pas kësaj detyrimi i Huadhënësit për të dhënë dhe vazhduar Huan shfuqizohet menjëherë; dhe

c) ato veprime të tjera që Huadhënësi mund të vendosë të marrë në diskrecionin absolut të tij.

Huamarrësi bie dakord t'i paguajë Huadhënësit, me kërkesë, të gjitha humbjet, shpenzimet e arsyeshme dhe detyrimet që Huadhënësi pëson si pasojë e një qenieje në vonesë (duke përfshirë, por pa u kufizuar tek interesi i paguar nga Huadhënësi huadhënësve të fondeve të marra prej tij për të mbuluar një shumë në vonesë). Një certifikatë nga një nëpunës rregullisht i autorizuar i Huadhënësit që përcakton shumën e këtyre humbjeve, shpenzimeve të arsyeshme dhe detyrimeve dhe bazën e llogaritjes së tyre kur i paraqitet Huamarrësit (përveç gabimeve të dukshme) është provë përfundimtare për shumën e kësaj humbjeje, shpenzimi dhe detyrimi, me kusht që kjo certifikatë të jetë mbështetur nga dokumente që japin prova se këto humbje, shpenzime dhe detyrime mbështeten nga dokumente të përshtatshme.

Huamarrësi, menjëherë sapo të vijë në dijeni, i bën njoftim me shkrim Huadhënësit, për:

a) një Ngjarje të Qenies në Vonesë; ose

b) çdo kusht, ngjarje ose veprim që me bërjen e njoftimit ose kalimin e një afati ose të dyja apo përmbushja e një kushti mund të çojë ose përbëjë Ngjarje të Qenies në Vonesë.

9. GARANCI DHE ANGAZHIME

9.1 Garancitë

Me qëllim për të shtyrë Huadhënësin të lidhë këtë Marrëveshje dhe të japë dhe të vazhdojë Huan e parashikuar në të, Huamarrësi në Datën e Pranimit jep garancitë e mëposhtme:

a) Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë është i autorizuar të veprojë në emër dhe për llogari të Republikës së Shqipërisë dhe të detyrojë ligjërisht Republikën e Shqipërisë. Për pasojë, detyrimet e Huamarrësit sipas kësaj Marrëveshjeje janë pa kufizim dhe pa kusht detyrime të Republikës së Shqipërisë. Republika e

Shqipërisë mund të paditet në emër të vet në lidhje me detyrimet e Huamarrësit sipas kësaj Marrëveshjeje;

b) Huamarrësi nuk është në vonesë për një detyrim pagesë dhe nuk ka ndodhur dhe nuk po vazhdon ndonjë Ngjarje e Qenies në Vonesë;

c) Huamarrësi ka tagrin të lidhë këtë Marrëveshje dhe të marrë hua dhe të nënshkruajë, të shpallë dhe të përmbushë këtë Marrëveshje dhe ka marrë të gjitha masat e nevojshme për të autorizuar termat dhe kushtet sipas kësaj Marrëveshjeje dhe të autorizojë ekzekutimin, shpalljen dhe përmbushjen e kësaj Marrëveshjeje që përbën një detyrim ligjor, të vlefshëm dhe detyrues për Huamarrësin të ekzekutueshëm në pajtim me termat e saj;

d) ekzekutimi, shpallja dhe përmbushja e kësaj Marrëveshjeje nuk shkel asnjë dispozitë të ligjit ose rregullores ekzistuese të Huamarrësit ose një marrëveshje, kontratë apo detyrim tjetër ku Huamarrësi është palë, ose që është detyruese për të ose sendet pasurore të tij;

e) të gjitha licencat, pëlqimet, regjistrimet ose aprovimet (qeveritare ose të tjera) të nevojshme në lidhje me ekzekutimin, shpalljen, përmbushjen, vlefshmërinë ose ekzekutueshmërinë e kësaj Marrëveshjeje janë marrë ose janë realizuar dhe janë në fuqi të plotë.

Garancitë e përcaktuara më sipër mbeten në fuqi pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje dhe konsiderohen të përsëriten në çdo datë të Huamarrjes dhe në çdo Datë të Pagesës së Interesit.

9.2 Angazhimet

Huamarrësi merr përsipër dhe angazhohet para Huadhënësit si më poshtë:

a) Regjistrat:

Huamarrësi realizon:

1. që: i) Blerësi i Projektit mban regjistra të përshtatshëm për të identifikuar mallrat dhe shërbimet e financuara nga Huaja; ii) Blerësi i Projektit deklaron përdorimin e tyre në Projekt; dhe iii) Blerësi i Projektit regjistron përparimin e Projektit, duke përfshirë shpenzimet e tij;

2. Përfaqësuesit e Huadhënësit lejohen të inspektojnë Projektin, ndërmarrjen e Blerësit të Projektit, mallrat dhe shërbimet e sjella në pajtim me Marrëveshjen e Blerjes dhe çdo regjistër dhe dokument përkatës;



a) t'i jepet ose t'i japë vetë Huadhënësit të gjithë informacionin që Huadhënësi mund të kërkojë në lidhje me shpenzimet e Huas, Projektit, Procesin e Vlerësimit dhe mallrat dhe shërbimet e dhëna në pajtim me Marrëveshjen e Blerjes.

b) *Pari Passu* dhe Pengu Negativ

Detyrimet e Huamarrësit sipas kësaj Marrëveshje janë të paktën *pari passu* dhe të barabarta me të gjitha detyrimet e tjera të mbetura, të pasiguruara dhe të pavarura të Huamarrësit. Nga Data e Pranimit dhe për sa kohë që një pjesë e Huas mbetet e papaguar, Huamarrësi nuk krijon apo bie dakord të krijojë një hipotekë, barrë, peng, rëndim apo garanci tjetër në tërësi ose pjesërisht mbi sendet e tij pasurore për të garantuar një detyrim ose për të siguruar një garanci të një detyrimi, përveç kur Huaja është e garantuar në mënyrë të barabartë ose e krahasueshme sipas bindjes së Huadhënësit.

c) Ndryshimi i Marrëveshjes së Blerjes

Huamarrësi nuk bën, lejon apo bie dakord për një amendim, ndryshim, modifikim apo përfundim të Marrëveshjes së Blerjes pa pëlqimin paraprak me shkrim të Huadhënësit.

10. LIGJI RREGULLUES DHE MOSMARRËVESHJET

a) Kjo Marrëveshje rregullohet nga ligji i Republikës së Austrisë.

b) Të gjitha mosmarrëveshjet në lidhje me këtë Marrëveshje, duke përfshirë përfundimin, vlefshmërinë dhe të drejtat dhe detyrimet e palëve zgjidhen përfundimisht sipas Rregullave të Pajtitimit dhe Arbitrazhit të zbatueshme në atë kohë të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë në Paris nga tre arbitra.

c) Vendi i arbitrazhit është Parisi. Gjuha që përdoret në gjykimin në arbitrazh është anglishtja.

d) Vendimi i arbitrazhit përcakton detyrimin e palëve në lidhje me shpenzimet shkaktuara nga palët.

e) Arbitrat bëjnë çdo përpjekje të zhvillojnë gjykimin dhe të përgatisin vendimin e tyre, në mënyrë që ta bëjnë vendimin ligjërish të zbatueshëm.

f) Vendimi për vendimin e arbitrazhit regjistrohet në çdo gjykatë që ka juridiksion ose mund të bëhet kërkesë te një gjykatë e tillë për

pranim gjyqësor të vendimit dhe për një urdhër ekzekutimi, sipas rastit.

g) Nëse Huadhënësi ndërmerr veprim gjyqësor (duke përfshirë padinë, arbitrazhin, sekuestron, ekzekutimin ose një masë tjetër ekzekutive ose konservuese) ndaj Huamarrësit në lidhje me një çështje që rrjedh nga kjo Marrëveshje, Huamarrësi heq dorë nga çdo e drejtë imuniteti që mund të ketë Huamarrësi.

Si përjashtim, Huamarrësi nuk heq dorë nga asnjë imunitet në lidhje me ekzekutimin e një vendimi arbitrazhi, në lidhje me:

i) “ambientet e misionit” të tashme ose të ardhme sipas përkufizimit të Konventës së Vjenës për Marrëdhëniet Diplomatike të nënshkruar më 1961, “ambientet konsullorë” të tashme ose të ardhme të përkufizuara në Konventën e Vjenës për Marrëdhëniet Konsullorë të nënshkruar më 1963 ose ndryshe të përdorura nga një diplomat ose mision diplomatik i Shqipërisë;

ii) një pasuri e patundshme që përfshihet në sferën e nenit 3, paragrafët 1-3 të ligjit shqiptar nr. 8743, datë 22.2.2001 “Mbi pasuritë e patundshme shtetërore”;

iii) çdo fond monetar dhe/ose shumë, të kërkueshme në momentin e ekzekutimit, që caktohet për përmbushjen e detyrimeve që Republika e Shqipërisë ka sipas ligjit ndërkombëtar publik.

h) Huamarrësi e cakton Ambasadën e Republikës së Shqipërisë si përfaqësues në Vjenë (aneksi 7).

11. TË PËRGJITHSHME

11.1 Njoftimet

Të gjitha njoftimet, kërkesat ose komunikimet e tjera kanë efekt, në rastin e njoftimit me shkrim me letër të regjistruar në momentin e marrjes, ose në rastin e njoftimit me faks, kur merret nga pala e cila në bazë të kësaj Marrëveshjeje lejohet ose i kërkohet të marrë një njoftim, kërkesë apo komunikim tjetër, drejtuar Huamarrësit ose Huadhënësit përkatësisht në adresat e tyre të përcaktuara në aneksin 1 ose në një adresë tjetër që ndonjë prej tyre mund t'i ketë specifikuar tjetrës me shkrim në pajtim me seksionin 11.1.

11.2 Titujt përshkrues

Titujt në këtë Marrëveshje janë vetëm për lehtësi reference dhe nuk përkufizojnë apo kufizojnë dispozitat e saj.



11.3 Heqja Dorë, Mjetet Mbrojtëse Kumulative

Asnjë moskryerje ose vonesë nga ana e Huadhënësit në ushtrimin e një të drejte, kompetence apo privilegji dhe asnjë ndërveprim ndërmjet Huamarrësit dhe Huadhënësit nuk ka efektin e heqjes dorë; apo asnjë ushtrim i vetëm ose i pjesshëm i një të drejte, kompetence ose privilegji nuk përjashton ushtrimin tjetër ose të mëtejshëm apo shtrimin e një të drejte, kompetence apo privilegji. Të drejtat dhe mjetet e mbrojtjes janë kumulative dhe nuk përjashtojnë asnjë të drejtë ose mjet mbrojtjeje që përndryshe do të kishte Huadhënësi. Asnjë njoftim apo kërkesë për Huamarrësin në çdo rast nuk i jep të drejtë Huamarrësit për një njoftim ose kërkesë tjetër apo njoftim në lidhje me të njëjtat rrethana dhe nuk përbën heqjen dorë nga të drejtat e Huadhënësit për ndonjë veprim tjetër ose të mëtejshëm në lidhje me këto rrethana pa njoftim ose kërkesë.

11.4 Pavlefshmëria e pjesshme

Nëse një dispozitë e kësaj Marrëveshjeje gjykohet nga një gjykatë organ tjetër kompetent të jetë e paekzekutueshme, vlefshmëria, ligjshmëria dhe ekzekutueshmëria e dispozitave të tjera nuk ndikohen apo cenohen në asnjë mënyrë nga kjo dhe palët bëjnë përpjekjet e tyre më të mira për të rishikuar dispozitën e pavlefshme për ta bërë atë të ekzekutueshme në pajtim me synimin e shprehur në të.

11.5 Transferimi

Huamarrësi nuk mund të kalojë ose transferojë të gjithë ose një pjesë të të drejtave dhe detyrimeve pa pëlqimin e mëparshëm me shkrim të Huadhënësit.

Huadhënësi mund të transferojë të drejtat dhe detyrimet e tij: i) pa pëlqimin e Huamarrësit, nëse subjekti që i transferohen është OeKB-ja ose (vetëm në rastin e Ngjarjes së Qenies në Vonesë) një banke tjetër apo instituti financiar; dhe ii) me pëlqimin paraprak me shkrim të Huamarrësit, që nuk refuzohet në mënyrë të paarsyeshme, të një subjekti tjetër.

11.6 Konfidencialiteti

Huamarrësi bie dakord që Huadhënësi ka të drejtë t'u paraqesë në një mënyrë që është e zakonshme për bankat të gjithë informacionin që merr në lidhje me këtë marrëveshje ose marrëdhënien e biznesit me Huamarrësin -

veçanërisht në interes të një mbrojtjeje të arsyeshme të kreditorëve - bankave, institucioneve të përbashkëta të bankave ose organizatave të preferuara për mbrojtjen e kreditorëve.

Huamarrësi bie dakord që Huadhënësi ka të drejtë t'u japë informacion që rrjedh nga kjo Marrëveshje ose marrëdhënia e biznesit e Huadhënësit me Huamarrësin personave ose shoqërive të mëposhtme:

a) një anëtar i grupit të shoqërive të Huadhënësit;

b) një subjekti të mundshëm që i transferohen të drejtat ose një personi apo shoqërie që mund të propozojë hyrjen në marrëdhënie kontraktuale me Huadhënësin në lidhje me këtë Marrëveshje;

c) OeKB-së dhe Republikës së Austrisë; dhe

d) një personi, autoriteti ose subjekti tjetër të cilit Huadhënësi duhet t'i tregojë çdo informacion të tillë në pajtim me një ligj ose urdhër gjykatë apo organ tjetër apo organ rregullator udhëzimet e të cilit duhet të përmbushë Huadhënësi.

11.7 Ndryshimet e Marrëveshjes

Kjo Marrëveshje nuk mund të ndryshohet ose të ndryshohet përveçse me instrumente me shkrim.

12. HYRJA NË FUQI

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi pas nënshkrimit të rregullt të palëve dhe ratifikimit nga Parlamenti i Republikës së Shqipërisë dhe publikohet në Fletoren Zyrtare shqiptare.

Në dëshmi të kësaj, palët kanë nënshkruar këtë Marrëveshje në datën e shkruar më sipër në dy origjinale në gjuhën angleze dhe versionin në anglisht është detyrues dhe ka përparësi ndaj çdo përkthimi.

Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë
që vepron në emër të Republikës së Shqipërisë
si Huamarrës

(përfaqësuar nga Ministria e Financave)

UniCredit Bank Austria AG si Huadhënës



ANEKSI 1

PALËT

Huamarrësi

Emri: Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë

që vepron në emër të Republikës së Shqipërisë si Huamarrës

(përfaqësuar nga Ministria e Financave)

Adresa: Ministria e Financave

Bul. Dëshmorët e Kombit, nr. 1

Tirana / Shqipëri

Faks: (355 4) 222 84 05

Tel. (355 4) 222 84 94

Në vëmendje të: Ministri i Financave

Huadhënësi

Emri: UniCredit Bank Austria AG

Adresa: Schottengasse 6-8, 1010 Vienna

Tel. +43 (0)5 05 05-56914

Faks: +43 (0)5 05 05-50318

Departamenti përgjegjës 8243 Structured
Trade & Export Finance

Në vëmendje të: Znj. Theresia Weymiers

Znj. Bettina Witzmann

ANEKSI 2

1. Projekti:

“Projekti i Përfunduar i Sistemit të Ujërave të Zeza Bilisht – Loti 1”

2. Marrëveshja e Blerjes:

Është marrëveshja nr. 1562, datë 30 qershor 2014, në shumën prej 2 998 856.00 eurosh, ndërmjet Eksportuesit të Projektit STRABAG AG, Spittal a. d. Drau, dhe Blerësit të Projektit Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit të Republikës së Shqipërisë, Tiranë, në shumën prej 2 998 856.00 euro në lidhje me Projektin.

3. Blerësi i Projektit:

Është Ministria e Punëve Publike dhe Transportit të Republikës së Shqipërisë, Drejtoria e Përgjithshme e Ujit dhe Kanalizimeve, Tiranë, Shqipëri.

4. Eksportuesi i Projektit:

Është STRABAG AG, Spittal a. d. Drau, Austri.

ANEKSI 3

1. Instrumenti i Kredisë (seksioni 2.2).

Një shumë që nuk kalon 2 998 856.00,00 euro (dy milionë e nëntëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e tetëqind e pesëdhjetë e gjashtë)

2. Periudha e Disponibilitetit (seksioni 2.2)

Nga Data e Mbylljes (sipas përcaktimit në seksionin 7) deri në datën që bie 18 muaj pas Datës së Mbylljes, që përfundon jo më vonë se 30 qershor 2016.

3. Interesi (seksioni 3.1)

0.00 në vit (zero për qind në vit)

4. Kamatëvonesa (seksioni 3.3)

3 muaj EURIBOR plus një marzh prej 2% në vit.

5. Tarifa e Përkushtimit (seksioni 4.1)

0,5 % në vit (zero pikë pesë për qind në vit)

6. Tarifa e Menaxhimit (seksioni 4.2)

0,5 % (zero pikë pesë për qind) e njësuar e Instrumentit të Kredisë

7. Primi i Garancisë (seksioni 4.4)

i) Primi i Garancisë e OeKB-së që paguhet në fillim

EURO 11,245.71 (vetëm treguese)

Shuma përfundimtare përcaktohet nga OeKB-ja me lëshimin e garancisë fillestare. Në rast se shuma përfundimtare ndryshon nga shuma e treguar, Huamarrësi paguan diferencën (sipas rastit) brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pasi të jetë njoftuar për këtë nga Huadhënësi.

ii) Primi i Garancisë së OeKB-së e pagueshme si Marzh

1.00 në vit (për qind në vit – vetëm tregues)

Sipas OeKB-së, norma e mësipërme mbështetet nga Ministria Federale Austriake e Financave nëpërmjet një ulje motivuese për një politikë zhvillimi që është afërsisht 217,420.00 euro. Norma përfundimtare dhe ulja përcaktohen nga OeKB-ja me lëshimin e garancisë fillestare të OeKB-së.

8. Tarifa e Trajtimit e OeKB-së

1.440.00 euro në lidhje me Sigurimin e Kredisë së Eksportit.

9. Datat e Shlyerjes së Detyrueshme (seksioni 5.1)

Shlyerja duhet të bëhet deri në 19 këste të barabarta të njëpasnjëshme gjysmëvjetore, i pari është i kërkuar 72 muaj pas Datës së



Pranimi Përfundimtar (nëse kjo datë është më parë) jo më vonë se 90 muaj pas Datës së Mbylljes, në çdo rast kësti i parë i pagesës bëhet i kërkueshëm jo më vonë se 30 qershor 2022.

10. Shuma e Parapagesës Opsionale (seksioni 5.2)

EURO 500,000.00

11. Periudha e Mbylljes (seksioni 7)

Një periudhë që fillon në Datën e Pranimi dhe jo më vonë se deri gjashtëdhjetë (60) ditë kalendarike pas Datës së Pranimi.

ANEKSI 4 PROCEDURA E PAGESËS

Huamarrësi autorizon Huadhënësin të paguajë në mënyrë të pakthyeshme Eksportuesit të Projektit deri në një maksimum total të shumës së Instrumentit të Kredisë i përmendur në aneksin 3, që është 2 998 856.00 euro, kundrejt prezantimit të dokumenteve të mëposhtme në pikat e Huadhënësit:

Parapagesa:

20% (njëzet për qind) të shumës së Marrëveshjes së Blerjes që është 599 771.20 euro (pesëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e një euro pikë njëzet cent) janë të pagueshme si parapagesë, në vend pas paraqitjes së:

- faturës nr. 0 që përcaktohet në Marrëveshjen e Blerjes në 1 (një) kopje origjinale dhe 3 (tri) kopje;

- kopje të Garancisë së Parapagimit e lëshuar nga një bankë austriake në një shumë prej 20% të Marrëveshjes së Blerjes.

Pagesa për shërbimet dhe punët

70% (shtatëdhjetë për qind) e shumës së Marrëveshjes së Blerjes që është 2,099,199.20 (euro dy milionë e nëntëdhjetë mijë e njëqind e nëntëdhjetë e nëntë/20) paguhet si parapagim për paketat përkatëse të punës pas paraqitjes së dokumenteve të mëposhtme:

Faturat (nr. 1-32) sipas përcaktimit në Marrëveshjen e Blerjes, secila në 1 (një) kopje origjinale dhe 3 (tri) kopje.

Secila faturë tregon:

- emrin (përshkrimin) e paketës përkatëse;

- datën;

- vlerën e paketës përkatëse në total;

- shumën që duhet të paguhet (për Eksportuesin e Projektit);

Faqe | 9212

- nënshkrimin e përfaqësuesve të autorizuar të palëve.

Pagesa kundrejt certifikatës së marrjes në dorëzim:

10% (dhjetë për qind) e shumës së Marrëveshjes së Blerjes që është EUR 299,885.60 (euro dy milionë e nëntëqind e nëntëdhjetë mijë e tetë qind tetëdhjetë e pesë /60) janë të pagueshme pas paraqitjes së:

- faturës nr. 33, lejimi i pranimi të përkohshëm sipas përcaktimit në Marrëveshjen e Blerjes, secila në 1 (një) kopje origjinale dhe 3 (tri) kopje;

- faturës nr. 34 të pranimi përfundimtar, sipas përcaktimit në Marrëveshjen e Blerjes, secila në 1 (një) kopje origjinale dhe 3 (tri) kopje.

Huadhënësi ka të drejtë të mbështetet në çdo dokument që besohet prej tyre që është i vërtetë dhe i saktë dhe të jetë nënshkruar ose dërguar nga personi i duhur. Huadhënësi nuk merr përgjegjësi apo detyrim për formën, mjaftueshmërinë, saktësinë, vërtetësinë, falsifikimin ose efektin ligjor të një dokumenti(eve), ose për kushtet e përgjithshme dhe/ose të veçanta të parashikuar në dokument(e) ose të vendosura në to; ai nuk merr përgjegjësi ose detyrim as për përshkrimin, sasinë, peshën, cilësinë, gjendjen, paketimin, dorëzimin, vlerën ose ekzistencën e mallrave ose shërbimeve të përfaqësuara nga një dokument(e) apo për mirëbesimin e veprimeve dhe/ose mosveprimeve, paaftësinë paguese, përmbushjen ose gjendjen nga dërguesit, transportuesit, paraqitësit, marrësit ose siguruesit e mallrave dhe asnjë person tjetër të tillë.

Dërgimet e pjesshme dhe paraqitja e pjesshme e dokumenteve lejohet.

Huadhënësi i jep Huamarrësit një njoftim me shkrim pasi t'i jetë kryer një Huamarrje Eksportuesit të Projektit.

Pas kryerjes së një Huamarrjeje për Eksportuesin e Projektit, Huadhënësi i dërgon dokumentet përkatëse Huadhënësit me shërbim të veçantë korrieri.

ANEKSI 5 OPINIONI LIGJOR (Model)

Nga: Ministri i Drejtësisë i Republikës së Shqipërisë:

Drejtuar: UniCredit Bank Austria AG

Datë



Unë,, duke vepruar në zotësinë time si Ministër i Drejtësisë i Republikës së Shqipërisë, i referohem marrëveshjes së kredisë së eksportit për një hua të butë nr. 233.258 për një shumë prej 2 998 856.00 eurosh (“Marrëveshja”) datë korrik 2014 dhe e lidhur ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë duke vepruar në emër të Republikës së Shqipërisë (përfaqësuar nga Ministria e Financave) si Huamarrës (Huamarrës) dhe UniCredit Bank Austria AG si Huadhënësi (Huadhënës). Unë nuk shpreh asnjë mendim në lidhje me ligjet e ndonjë juridiksioni përveç se të Republikës së Shqipërisë.

Unë kam shqyrtuar një kopje të nënshkruar të Marrëveshjes dhe ato dokumente të tjera që i kam konsideruar të nevojshme dhe të duhura për t’i shqyrtuar me qëllim që të japë këtë mendim. Termat e përkufizuar në Marrëveshje kanë të njëjtin kuptim, përveç kur përcaktohen ndryshe.

Bazuar sa më sipër, unë jam i mendimit që:

a) Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë është i autorizuar të veprojë në emër dhe për llogari të Republikës së Shqipërisë dhe të detyrojë ligjërisht Republikën e Shqipërisë. Për pasojë, detyrimet e Huamarrësit sipas kësaj Marrëveshjeje janë pa kufizim dhe pa kusht detyrime të Republikës së Shqipërisë. Republika e Shqipërisë mund të paditet në emër të vet në lidhje me detyrimet e Huamarrësit sipas kësaj Marrëveshjeje.

b) Ministria e Financave autorizohet të veprojë në emër të Huamarrësit dhe të detyrojë ligjërisht Huamarrësin. Për pasojë, të gjitha detyrimet sipas kësaj Marrëveshjeje janë detyrime të vlefshme, detyruese dhe të ekzekutueshme të Huamarrësit. Huamarrësi ka zotësinë të paditë dhe të paditet në emrin e vet.

c) Huamarrësi ka kompetencën të lidhë dhe të përmbushë këtë Marrëveshje. Huamarrësi ka marrë të gjitha masat e nevojshme (qeveritare dhe të tjera) për të autorizuar nënshkrimin e Marrëveshjes sipas termave dhe kushteve të parashikuara në të dhe vënien në ekzekutim, shpalljen dhe përmbushjen e Marrëveshjes.

d) Marrëveshja është nënshkruar nga z. në cilësinë e tij si Ministër i Financave të Republikës së Shqipërisë.

e) Marrëveshja e nënshkruar nga Ministri i Financave në emër të Huamarrësit përmban

detyrime të ligjshme, të vlefshme dhe detyruese të Huamarrësit, të ekzekutueshme në gjykatat e Republikës së Shqipërisë në pajtim me termat e saj.

f) Personi ose personat që nënshkruajnë Marrëveshjen, të cilët nënshkruajnë ose të certifikojnë një dokument tjetër në lidhje me Marrëveshjen kanë të gjitha kompetencat dhe autorizimet e nevojshme për ta bërë këtë në emër të Huamarrësit.

g) Nënshkrimi dhe përmbushja e Marrëveshjes dhe transaksionet e parashikuara në të nuk bien në kundërshtim me: i) asnjë ligj, rregullore apo vendim zyrtar apo gjyqësor; ii) asnjë traktat, marrëveshje ose dokument apo instrument tjetër ku Huamarrësi dhe/ose Republika e Shqipërisë është palë ose që është detyruar për të ose ndonjë prej sendeve të tij pasurore.

h) Të gjitha autorizimet, aprovimet (duke përfshirë, sipas rastit, aprovimet e kontrollit të këmbimit), pëlqimet, licencat, përjashtimet, depozitimet, regjistrimet, noterizimet dhe çdo kërkesë tjetër të institucioneve qeveritare, gjyqësore dhe publike dhe autoriteteve të nevojshme dhe të këshillueshme në lidhje me ekzekutimin, dorëzimin, vlefshmërinë dhe përmbushjen e Marrëveshjes dhe çdo pagesë që bëhet sipas saj, janë marrë ose realizuar dhe janë në fuqi të plotë dhe Huamarrësi ka autoritetin e plotë të kryejë të gjitha pagesat sipas Marrëveshjes në EURO (euro).

i) Të gjitha shumat e pagueshme nga Huamarrësi sipas Marrëveshjes mund të bëhen të lira dhe pa zbritje për llogari të tatimeve, detyrimeve, zbritjeve ose barrëve të tjera nga Republika e Shqipërisë, një nënndarje politike apo autoriteti tatimor. Në rastin e një ndalimi në lidhje me pagesat e interesit sipas Marrëveshjes, detyrimi i Huamarrësit për të paguar shuma të tjerë shtesë në pajtim me seksionin 6.4 është i vlefshëm dhe i ekzekutueshëm.

j) Kjo Marrëveshje ratifikohet nga Parlamenti i Republikës së Shqipërisë dhe publikohet në Fletoren Zyrtare shqiptare, dhe nuk është e nevojshme ose e këshillueshme të sigurohet ligjshmëria, vlefshmëria, ekzekutueshmëria ose pranueshmëria me prova e Marrëveshjes nëpërmjet depozitimit, regjistrimit të ndonjë autoritet apo agjenci tjetër qeveritare në Republikën e Shqipërisë.



k) Zgjedhja e Ligjit të Republikës së Austrisë për të rregulluar Marrëveshjen është një zgjedhje e vlefshme e ligjit dhe do të njihet dhe ekzekutohet në çdo gjykatë të Republikës së Shqipërisë.

Huamarrësi i nënshtrohet ligjit civil në lidhje me detyrimet e tij sipas Marrëveshjes. Hyrja në fuqi dhe përmbushja e Marrëveshjes nga Huamarrësi përbën veprim juridik privat dhe tregtar. Heqja dorë nga imuniteti në seksionin 10. (g) të Marrëveshjes është e vlefshme dhe detyruese për Huamarrësin.

l) Nuk është e nevojshme sipas ligjit të Republikës së Shqipërisë: i) me qëllim që t'i mundësohet Huadhënësit të ekzekutojë të drejtat e tij përkatëse sipas Marrëveshjes; ose ii) për shkak të nënshkrimit, shpalljes, përmbushjes dhe ekzekutimit të Marrëveshjes, që Huadhënësi të licencohet, kualifikohet ose të ketë të drejtën të zhvillojë biznes në Republikën e Shqipërisë.

Huadhënësi nuk është as rezident, me vendbanim dhe nuk zhvillon biznes dhe nuk i nënshtrohet tatimit në Republikën e Shqipërisë për shkak të nënshkrimit, shpalljes, përmbushjes dhe ekzekutimit të Marrëveshjes.

m) Dispozitat e seksionit 10 të Marrëveshjes janë të ligjshme, të vlefshëm dhe detyrues sipas ligjit të Republikës së Shqipërisë.

Gjykatat e Republikës së Shqipërisë njohin çdo vendim dhe/ose vendim arbitrazhi në lidhje me Marrëveshjen si të vlefshëm dhe përfundimtarë dhe i ekzekutojnë këto vendime dhe/ose vendime arbitrazhi.

Një vendim i përcaktuar në euro (euro) do të njihet dhe ekzekutohet në Republikën e Shqipërisë.

Sipas njohurive të mia më të mira, asnjë gjykim, procedurë arbitrazhi apo procedurë administrative nuk zhvillohen apo janë në gjykim e sipër dhe, sipas njohurive tona, të mundshme ndaj Huamarrësit që mund të kenë si rezultat një ndryshim negativ të konsiderueshëm në gjendjen financiare të Huamarrësit.

n) Marrëveshjet dhe të gjitha dokumentet e tjera nuk përmbajnë asnjë dispozitë që konsiderohet e paekzekutueshme sipas ligjit të Republikës së Shqipërisë.

o) Detyrimet e Huamarrësit sipas Marrëveshjes gjithmonë renditen të barasvlershme me të gjitha detyrimet e tjera të huamarrësit, përveç

atyre detyrimeve që preferohen detyrimisht nga ligji.

Ky opinion ligjor jepet vetëm në interes të Huadhënësit dhe nuk mund t'u deklarohet personave të tjerë.

Me respekt

ANEKSI 6

KONFIRMIM QË MARRËVESHJA E BLERJES ËSHTË NË FUQI TË PLOTË

(Huadhënësi)

Lënda: Marrëveshja e kredisë së eksportit për një hua të butë nr. 233 258 për një shumë prej 2,998,856.00 euro (Marrëveshja) datë korrik 2014 dhe e lidhur ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë duke vepruar në emër të Republikës së Shqipërisë (përfaqësuar nga Ministria e Financave) si Huamarrës (Huamarrës) dhe UniCredit Bank Austria AG si Huadhënësi (Huadhënës).

Të nderuar zotërinj,

Ne konfirmojmë se Marrëveshja e Blerjes nr. 1562 e lidhur më 3 qershor 2014 ndërmjet STRABAG AG, Spittal a.d. Drau dhe Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës së Republikës së Shqipërisë ka hyrë në fuqi më (.....).

Spittal a.d. Drau,

.....
STRABAG AG

ANEKSI 7

PRANIMI I EMËRIMIT TË PËRFAQËSUESIT

(Huadhënësi)

Lënda: Marrëveshja e kredisë së eksportit për një hua të butë nr. 233. 258 për një shumë prej 2, 998, 856.00 eurosh ("Marrëveshja") datë korrik 2014 dhe e lidhur ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë duke vepruar në emër të Republikës së Shqipërisë (përfaqësuar nga Ministria e Financave) si Huamarrës ("Huamarrës") dhe UniCredit Bank Austria AG si Huadhënësi ("Huadhënës").

Të nderuar Zotërinj,

Si Ambasador i Republikës së Shqipërisë në Vjenë, Republika e Austrisë, në pranoj, emërimin e ambasadorit të Republikës së Shqipërisë në



Vjenë, Republika e Austrisë, si përfaqësues i autorizuar i Huamarrësit për të shërbimet si Përfaqësues dhe në lidhje me këtë Marrëveshje.

Adresa e Ambasadorit të Republikës së Shqipërisë në Vjenë, Republika e Austrisë, është:

.....

Nëse do të ketë ndryshime në adresën time, unë do t'ju njoftoj me shkrim pa vonesë.

Me respekt

.....

Ambasada e Republikës së Shqipërisë në Austri

vendi, data

LIGJ
Nr. 149/2014

PËR RATIFIKIMIN E NDRYSHIMIT NR. 2 TË MARRËVESHJES SË NDIHMËS PËR OBJEKTIVA ZHVILLIMI NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS "PËR FORCIMIN E SHTETIT TË SË DREJTËS DHE QEVERISJEN E MIRË DHE KRIJIMIN E KUSHTEVE PËR NJË RRIJJE EKONOMIKE ME BAZË TË GJERË DHE TË QËNDRUESHME"

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet ndryshimi nr. 2 i marrëveshjes së ndihmës për objektiva zhvillimi ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës "Për forcimin e shtetit të së drejtës dhe qeverisjen e mirë dhe krijimin e kushteve për një rritje ekonomike me bazë të gjerë dhe të qëndrueshme".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 30.10.2014

Shpallur me dekretin nr. 8796, datë 18.11.2014 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

Marrëveshje e Ndihmës së USAID-it nr. 182-DOAG-13-003

AMENDIM NUMËR DY
I MARRËVESHJES SË NDIHMËS
PËR OBJEKTIVA ZHVILLIMI NDËRMJET
QEVERISË SË SHTETEVE TË
BASHKUARA TË AMERIKËS DHE
KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PËR
FORCIMIN E SHTETIT TË SË DREJTËS
DHE QEVERISJES SË MIRË DHE
KRIJIMIN E KUSHTEVE PËR NJË RRIJJE
EKONOMIKE ME BAZË TË GJERË DHE
TË QËNDRUESHME

Datë 30 shtator 2013

Amendim numër dy i marrëveshjes së ndihmës për objektiva zhvillimi ndërmjet Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës që vepron nëpërmjet Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar "USAID" dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë që vepron nëpërmjet Ministrisë së Financave (më poshtë e quajtur "Përfituesi i Ndihmës)

Neni 1

Qëllimi i amendimit

Ky amendim numër dy i marrëveshjes së ndihmës së USAID për objektiva zhvillimi, i datës 30 shtator 2013 "Marrëveshja", bëhet midis palëve me qëllim që t'i japë Përfituesit të Ndihmës një ndihmë shtesë për një milion e katërqind e shtatë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e dy dollarë amerikanë "USD" (\$, 1,407,662) dhe të modifikojë buxhetin në përputhje me sa më sipër. Kjo shumë shtesë e fondeve e bën shumën e angazhuar të marrëveshjes deri në këtë datë, në një shumë që nuk kalon njëmbëdhjetë milionë e treqind e



trembëdhjetë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e tre dollarë amerikanë "USD" (\$ 11,313,953).

Neni 2

Kontributet e palëve

Neni 3, seksioni 3.1 (a) I Marrëveshjes fshihet tërësisht dhe teksti në vazhdim e zëvendëson atë.

"Seksioni 3.1. Kontributi i USAID-it

a) Granti. Për të ndihmuar arritjen e objektivave të vendosura në këtë Marrëveshje, USAID në përputhje me aktin e ndihmës së huaj të vitit 1961, të ndryshuar, i jep Përfituesit të Ndihmës, sipas kushteve të Marrëveshjes, një shumë që nuk kalon njëmbëdhjetë milionë e

treqind e trembëdhjetë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e tre dollarë amerikanë "USD" (\$11,313,953) (Granti).

Neni 3

Plani financiar

Plani financiar sipas shtojcës 1, përshkrimit të zgjeruar, seksioni III, fshihet tërësisht dhe teksti në vazhdim e zëvendëson atë.

III. PLANI FINANCIAR

Plani financiar për kryerjen e objektivave dhe të rezultateve, paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Plani financiar i Marrëveshjes së Ndihmës për Objektiva Zhvillimi			
Nr.	Fusha e Programit	Vitit fiskal (VF) 2013	Totali VF2013-VF2016
1	Shteti ligjor dhe të drejtat e njeriut	\$ 2,189,000	\$5,339,000
2	Qeverisja e mirë	\$ 4,557,662	\$12,345,662
3	Shoqëria Civile	\$0	\$1,000,000
4	Tregtia dhe Investimet	\$500,000	\$1,500,000
5	Sektori Financiar	\$1,250,000	\$1,950,000
6	Konkurrueshmëria e sektorit privat	\$1,817,000	\$4,817,000
7	Mbështetja për programin	\$1,000,291	\$3,000,000
	Totali	\$11,313,953	\$29,951,662

Neni 4

Termat dhe kushtet e tjera

Përveç amendimeve në këtë dokument, të gjitha termat dhe kushtet e tjera të Marrëveshjes mbeten plotësisht në fuqi. Të gjitha termat me germa kapitale në këtë amendim numër dy do të kenë kuptimet që u jepen në Marrëveshje.

Në dëshmi të kësaj, Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Përfituesi i Ndihmës, secili duke vepruar nëpërmjet përfaqësuesve të tyre të autorizuar, kanë bërë që ky amendim Numër Dy i Marrëveshjes të nënshkruhet në emër të tyre dhe të dërgohet në ditën dhe vitin e cituar më sipër.

QEVERIA E SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS

Nga

Datë

Pozicioni: Drejtor Misioni në Detyrë

USAID Shqipëri

KËSHILLI I MINISTRAVE I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Nga

Datë

Emri: Shkëlqim Cani

Pozicioni: Ministër i Financave

LIGJ

Nr. 153/2014

PËR FALJEN E KAMATËVONESAVE DHE GJOBAVE PËR KONTRIBUTET E DETYRUESHME TË SIGURIMEVE SHOQËRORE TË PAPAGUARA NGA PERSONAT E VETËPUNËSUAR NË BUJQËSI

Në mbështetje të neneve 78, 83, pikat 1 e 2, 84, pika 4, dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,



KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Personave të vetëpunësuar në bujqësi u falen kamatëvonesat dhe gjobat e kontributeve të sigurimeve shoqërore, të papaguara deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji. Ata mund të paguajnë kontributet e sigurimeve shoqërore për periudha të kaluara dhe për vitin 2014 pa kamatëvonesa.

Neni 2

Kamatëvonesat dhe gjobat e papaguara falen edhe kur kontributet për sigurimet shoqërore janë paguar para hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 3

E drejta e personave të vetëpunësuar në bujqësi që të përfitojnë nga falja e kamatëvonesave dhe gjobave, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, ushtrohet deri në datën 31 dhjetor 2014.

Neni 4

Kamatëvonesat dhe gjobat për kontributet për sigurimet e detyrueshme shoqërore, të paguara para hyrjes në fuqi të këtij ligji, nuk kthehen.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Miraturar në datën 18.11.2014

DEKRET

Nr. 8797, datë 20.11.2014

**PËR SHPALLJE LIGJI DHE DHËNIEN E
PËLQIMIT PËR HYRJEN NË FUQI
MENJËHERË TË LIGJIT**

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe 4, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Neni 1

Shpalljen e ligjit nr. 153/2014 "Për faljen e kamatëvonesave dhe gjobave për kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore të papaguara nga personat e vetëpunësuar në bujqësi".

Neni 2

Dhëniën e pëlqimit për hyrjen në fuqi menjëherë të ligjit nr. 153/2014 "Për faljen e kamatëvonesave dhe gjobave për kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore të papaguara nga personat e vetëpunësuar në bujqësi".

Neni 3

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË
Bujar Nishani

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare me çmimin 16 000 lekë ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare me çmimin 14 000 lekë (ky çmim nuk përfshin shpërndarjen në adresë).

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2014

Adresa
Bulevardi “Gjergj Fishta”,
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”,
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 32 lekë